9.2.4. *Parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi akti normativ: i. diskriminon mjekët në raport me profesionet e tjera të rregulluara, si: stomatologu, farmacisti, infermieri ose psikologu; ii. mjekët që punojnë në strukturat universitare me autonomi spitalore në raport me kolegët e tjerë që punojnë në struktura të tjera publike; si dhe iii. mjekët që punojnë në strukturat shëndetësore me autonomi spitalore dhe që do të lejohen të ushtrojnë dypunësimin në raport me kolegët e tjerë që punojnë në të njëjtën strukturë, por nuk lejohen të ushtrojnë dypunësim. Ky diskriminim paraqitet edhe në raport me masat disiplinore dhe pavarësinë, si dhe vetërregullimin e Urdhrit të Mjekut në procedimet disiplinore.

10. *Kërkuesi,* *Urdhri i Mjekëve,* në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

10.1 *Për legjitimimin*

Kërkuesi legjitimohet, pasi është person juridik i krijuar me ligj si ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit të Mjekut dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut. Ai ka interes real për mbrojtjen e standardeve kushtetuese të funksionimit të profesionit të mjekut në mënyrë cilësore dhe të pavarur. Po kështu, pretendimet e tij janë me natyrë kushtetuese, ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, për sa kohë kërkuesi ka legjitimitet të kushtëzuar, Gjykata ushtron kontrollin kushtetues vetëm nëse provohet shkelje e të drejtave subjektive.

10.2 *Për themelin e kërkesës*

Akti normativ nr. 2/2024 dhe VKM-ja nr. 85/2025 kanë cenuar:

10.2.1 *Nenin 101 të Kushtetutës,* pasi Këshilli i Ministrave nuk ka arritur të provojë nevojën që ka ekzistuar për miratimin e aktit normativ dhe faktin nëse fenomeni i lëvizjes së mjekëve gjatë orarit zyrtar në klinika private ka ekzistuar prej kohësh, duke mos u bazuar në dokumente, raporte ose statistika. Këshilli i Ministrave nuk ka argumentuar nëse fenomeni mund të zgjidhej me ndërhyrje normative ose ishte problematikë e moszbatimit të rregullave ligjore aktuale dhe mosveprimit të autoriteteve për formimin e mekanizmave kontrollues dhe monitorues për respektimin e orarit të punës. Po kështu, nuk përmbushet as kriteri i urgjencës, pasi ngjarja që ka shërbyer për fillimin e procesit është ndjekur penalisht nga prokuroria, ndaj Këshilli i Ministrave nuk pengohej të ndiqte procedurën e zakonshme ligjvënëse. Çështjet e disiplinës në punë dhe respektimi i orarit nuk përbëjnë urgjencë që kërkon miratimin e një akti normativ.

10.2.2 *Lirinë e organizimit dhe parimin e sigurisë juridike të lidhur me parimin e shtetit të së drejtës*, të garantuara nga nenet 46 dhe 4 të Kushtetutës. Akti normativ cenon vetërregullimin e Urdhrit të Mjekëve, si ent i pavarur në shërbim të dhënies së kujdesit mjekësor cilësor të individëve, veçanërisht në nenet 11 dhe 16, të ligjit nr. 123/2014. Ky parim cenohet edhe nga VKM-ja nr. 85/2025, e cila parashikon organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelimit. Urdhri i Mjekëve, si ent i pavarur me anëtarësim të detyrueshëm, duhet të ketë autonomi nga Ministria e Shëndetësisë. Dispozitat ligjore të kundërshtuara dobësojnë pavarësinë organizative dhe funksionale të Urdhrit të Mjekëve në disa drejtime. *Së pari*, kompetenca e Ministrisë së Shëndetësisë për të miratuar Kodin e Etikës cenon vetëqeverisjen profesionale të mjekëve, ul përgjegjshmërinë e tyre dhe dëmton besueshmërinë e profesionit, duke lënë pa qëllim dhe efekt vetë misionin e Urdhrit të Mjekëve. *Së dyti*, organizimi dhe funksionimi i komisioneve të disiplinës dhe të apelimit, të cilat rregullohen me VKM, cenojnë pavarësinë organizative të Urdhrit të Mjekëve dhe politizimin e vendimmarrjes, si dhe krijojnë paqartësi, pasi nuk specifikohet sesi do të funksionojnë këto komisione dhe cilat do të jenë garancitë ndaj mjekëve të proceduar administrativisht. E drejta për t'u gjykuar nga një organ i pavarur profesional nuk është parashikuar me një ligj të miratuar me shumicë të cilësuar. Kjo paqartësi thellohet edhe nga VKM-ja nr. 85/2025, e cila parashikon se një nga anëtarët e komisionit do të jetë ekspert i jashtëm pa e qartësuar mënyrën e përzgjedhjes ose organizmin nga i cili do të

përzgjidhet, nisur nga fakti se të gjithë mjekët janë pjesë e Urdhrit të Mjekëve. Edhe pjesëmarrja e dy përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë në komision cenon pavarësinë, veçanërisht për shkak se vendimet merren me të paktën 3 anëtarë, duke e lënë praktikisht atë në dorë të ekzekutivit. Delegimi i Këshillit të Ministrave në nenin 16 të aktit normativ parashikon se akti nënligjor mund të ndryshohet lehtësisht në ndryshim nga ligji, i cili garanton qëndrueshmëri. VKM-ja nr. 85/2025 parashikon shpërblim për anëtarët e komisioneve, duke zvogëluar garancitë e Komisionit të Apelimit, të cilët financohen nga buxheti i shtetit, në ndryshim nga Komisioni i Disiplinës, të cilët financohen nga Urdhri i Mjekëve, ndërkohë që relacioni shoqërues i aktit normativ parashikon se ai nuk shoqërohet me efekte financiare. Për më tepër, ndonëse Këshilli i Ministrave ka pasur detyrimin për nxjerrjen e VKM-së brenda 3 muajve, ajo është miratuar në datën 5.2.2025, duke sjellë pasoja në drejtim të paqartësisë së funksionimit të këtyre organeve disiplinore.

10.2.3 *Lirinë e ushtrimit të profesionit dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike të lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe të drejtën për kujdes shëndetësor,* të garantuara nga nenet 11, 17, 49 dhe 55 të Kushtetutës, për sa i përket raportit 30% të punësimit në sektorin publik dhe privat dhe faktit se masa disiplinore e heqjes së licencës nuk shuhet asnjëherë. Ndërhyrja nuk plotëson kriterin e proporcionalitetit, pasi përbën një masë të ashpër në raport me qëllimin që synohet të arrihet. *Së pari*, kufizimi i punësimit në sektorin privat në 30% të orëve mujore ka fuqi prapavepruese dhe nuk janë parashikuar dispozitat tranzitore, duke u dëmtuar planet e aktivitetit ekonomik të mjekëve dhe pa marrë parasysh kreditë ose detyrimet financiare të tyre. Po kështu, raporti 30% nuk është argumentuar ose bazuar në ndonjë studim specifik. *Së dyti,* mosshuarja e masës disiplinore cenon dinjitetin njerëzor dhe thelbin e së drejtës për të ushtruar profesionin e mjekut. Po kështu, këto të drejta cenohen edhe nga neni 5 i aktit normativ që ka shtuar nenin 8/a të ligjit në lidhje me kushtet dhe procedurën që duhet të ndjekë një mjek, i cili kërkon të ushtrojë profesionin në një institucion shëndetësor jopublik. Në këtë mënyrë cenohet aksesi në shëndetësi i qytetarëve dhe *e drejta për kujdes shëndetësor cilësor*.

10.2.4 *Procesin e rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, i cili zbatohet edhe në procesin ligjvënës, pasi kërkuesit nuk i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur brenda një kohe të arsyeshme gjatë procesit ligjvënës. Ndonëse Urdhri i Mjekëve është njoftuar për seancën dëgjimore në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, ky njoftim ka ardhur pas kërkesës për të pasur seancë dëgjimore. Kërkuesit nuk i është dhënë kohë e mjaftueshme (vetëm 3 ditë) për t'u përgatitur, dëgjuar dhe mbrojtur në seancën dëgjimore, veçanërisht duke mbajtur në konsideratë faktin se akti normativ është miratuar në kushte urgjence.

11. *Subjekti i interesuar, Kuvendi*, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se:

11.1 *Për juridiksionin e Gjykatës*

Urdhri i Mjekëve nuk është një organ kushtetues, nuk është i parashikuar nga Kushtetuta dhe nuk përmendet në të, për rrjedhojë organizimi dhe funksionimi i tij nuk gëzojnë mbrojtje kushtetuese. Ligjvënësi ka diskrecion të plotë që të vendosë për organizimin e profesioneve dhe formën e organizimit dhe kërkuesja, Sindikata, nuk ka arritur të provojë se cila e drejtë themelore kushtetuese i është cenuar nga mënyra e organizimit të Urdhrit të Mjekëve.

11.2 *Për legjitimimin e kërkueses, Sindikatës*

Kërkuesja nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për të kundërshtuar organizimin e Urdhrit të Mjekëve, pasi akti normativ nuk ka asnjë ndikim mbi vetë atë. Ajo është një sindikatë me organizim vullnetar, me objekt të ndryshëm nga Urdhri i Mjekëve, i cili është i krijuar me ligj. Për rrjedhojë, ajo nuk legjitimohet që të kërkojë shfuqizimin e një ligji që rregullon veprimtarinë e një organizate tjetër. Kërkuesja nuk legjitimohet as për pretendimin për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, pasi është subjekt i kushtëzuar dhe nuk provohet se asaj i janë cenuar të drejta kushtetuese. Ajo nuk legjitimohet as për pretendimin e cenimit të parimit të shtetit të së drejtës, pasi krijimi i institucioneve administrative që shërbejnë për rregullimin e profesioneve të ndryshme është diskrecion i Kuvendit. Urdhri i Mjekëve nuk është organ kushtetues ose institucion i parashikuar nga Kushtetuta. Ajo nuk legjitimohet as nga ana formale, pasi nuk paraqitet asnjë dokumentacion që autorizon kryetarin e Sindikatës të veprojë në emër dhe për llogari të saj. Po kështu, kryetari i Sindikatës rezulton të jetë zgjedhur që në datën 14.11.2019, ndonëse statuti parashikon se ai ka një mandat 1-vjeçar.

11.3 *Për themelin e pretendimeve*

11.3.1 Pretendimi për cenimin e *nenit 101 të Kushtetutës* është i pabazuar. Për sa i përket *kriterit të nevojës*, pretendimi se një ngjarje e vetme nuk mund të justifikojë nismën ligjore është i pabazuar. Edhe deklaratat e mëparshme të Këshillit të Ministrave nuk mund të merren në konsideratë, pasi ato janë deklarata politike dhe nuk bazohen në raporte inspektimi. Pretendimi se ekzistojnë akte të tjera ligjore dhe nënligjore nuk qëndron, pasi Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave nuk kanë asnjë ndalim kushtetues për të miratuar një legjislacion të ri më efektiv. Shkelja e akteve ekzistuese passjell përgjegjësi disiplinore, e cila është shmangur nga Urdhri i Mjekëve, ndonëse kjo përgjegjësi konkurron me përgjegjësinë penale. Fakti se akti normativ është miratuar një muaj pas ngjarjes së ndodhur nuk përbën argument kushtetues. Lidhur me pretendimin për masën e "përkohshme", në rastin konkret akti normativ është miratuar nga Kuvendi dhe konsiderohet i përhershëm.

11.3.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës,* për shkak të cenimit të vetërregullimit të Urdhrit të Mjekëve është i pabazuar, pasi krijimi i institucioneve administrative që shërbejnë për rregullimin e profesioneve të ndryshme është diskrecion i Kuvendit. Shteti shqiptar nuk ka detyrim për të miratuar një model të caktuar të huazuar nga shtete të tjera.

11.3.3 Pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, së drejtës për punë dhe ushtrimit të profesionit të lidhur me *parimin e proporcionalitetit* është i pabazuar, pasi mjekëve nuk u ndalohet të punojnë me kohë të plotë në qendrat shëndetësore publike ose private, ndërsa pretendimi se ata mund të punojnë 16 orë në ditë nuk gjen mbështetje ligjore. Akti normativ përmbush kriterin e kufizimit vetëm me ligj, është miratuar për një interes publik me qëllim mbrojtjen e së drejtës për kujdes shëndetësor dhe atë të proporcionalitetit. Argumentet e kërkueses në këtë drejtim nuk janë kushtetuese, pasi zgjedhjet politike të ekzekutivit dhe të ligjvënësit nuk mund të vihen në diskutim nga Gjykata. Akti normativ synon të rregullojë situatën kur mjeku kërkon të punësohet njëkohësisht në qendrat shëndetësore publike dhe private në respektim të masave kufizuese, parashikime të cilat gjenden edhe në shtete të tjera. Akti normativ nuk i ka ndaluar mjekët të punojnë me kohë të plotë në qendrat shëndetësore publike ose jopublike, për rrjedhojë nuk ka kufizuar të drejtën për punë dhe profesion të mjekëve. Ai i lë të lirë të zgjedhin nëse duan të punojnë në qendra shëndetësore publike ose private me kohë të plotë.

Për sa i përket pretendimit të kërkueses lidhur me nenin 8/a, pika 3, pra pamundësinë e mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës ekskluziv ose joekskluziv, ligji nr. 55/2022, datë 7.7.2022, "Për shërbimin spitalor" *(ligji nr. 55/2022)* ka parashikuar se kur një spital arrin autonomi të plotë spitalore, marrëdhënia e punësimit do të rregullohet nga vetë spitali dhe jo nga ligji nr. 123/2014. Edhe pretendimi për mungesën e parashikimit të kontratave ekskluzive dhe joekskluzive është i pabazuar, pasi ato materializohen në ligjin nr. 55/2022, i cili nuk është objekt kontrolli në këtë gjykim kushtetues. Argumentet e kërkueses janë hipotetike dhe i përkasin periudhës pas vitit 2026 e në vijim.

Në lidhje me pretendimin për ashpërsinë e masave disiplinore, evidentohet se për një periudhë 18-vjeçare numri i procedimeve ka qenë shumë i ulët, çka tregon se rregulli i deritanishëm nuk ka rezultuar efektiv. Për këtë shkak, nevojitet ashpërsimi i masave dhe miratimi i Kodit të ri Etik dhe Deontologjik nga ministri përkatës.

11.3.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi profesioni i mjekut nuk është i njëjtë me profesionet e tjera të infermierit, stomatologut ose të farmacistit, nisur nga përkufizimi që shkenca gjuhësore u jep këtyre termave, arsimimi që ata zhvillojnë dhe kuadri ligjor që rregullon këto profesione.

12. *Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave*, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar:

12.1 *Për juridiksionin e Gjykatës*

Kërkuesit nuk kanë argumentuar se cila e drejtë kushtetuese e tyre ose e anëtarëve cenohet nga organizimi që ligjvënësi i ka bërë Urdhrit të Mjekëve, për sa kohë ai nuk është një organ kushtetues dhe as i parashikuar nga Kushtetuta. Po kështu, Urdhri i Mjekëve nuk është një organizim vullnetar, por organ i së drejtës administrative i krijuar me ligj dhe pjesëmarrja e mjekëve është detyruese, pra nuk mund të pretendohet se cenohet e drejta për organizim e mjekëve. Çështja objekt shqyrtimi nuk përmban probleme të kushtetutshmërisë, por të raportit që duhet të kenë në zbatim norma me fuqi

të njëjtë juridike, të cilat nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

12.2 *Për legjitimimin e kërkuesve*

Kërkuesja, Sindikata, ka objekt të ndryshëm nga kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, pasi ky i fundit është një organizatë e krijuar me ligj, ndërsa kërkuesja është organizim vullnetar, pra ka anëtarësi dhe qëllime të ndryshme. Kërkuesja nuk mund të kërkojë shfuqizimin e një ligji që rregullon veprimtarinë e një organizate tjetër vetëm për faktin se një pjesë e veprimtarisë së saj përfaqëson edhe anëtarë të asaj organizate. Edhe për sa u përket pretendimeve për cenimin e neneve 11, 17, 49, 55 dhe 59 të Kushtetutës, ato nuk lidhen me veprimtarinë e Sindikatës, por janë të drejta dhe liri të anëtarëve të saj. Akti normativ nuk ka cenuar një të drejtë të lidhur me Sindikatën për shkak të shkeljeve procedurale të pretenduara. Po kështu, ajo nuk legjitimohet *ratione personae* për pretendimin për cenimin e së drejtës së shtetasve për kujdes shëndetësor dhe për standardin më të lartë shëndetësor, të garantuara nga nenet 55 dhe 59, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, pasi nuk provon interesin e drejtpërdrejtë. Në drejtim të legjitimimit formal mungon autorizimi për përfaqësuesin që të veprojë në emër dhe për llogari të Sindikatës dhe nuk rezulton se cili organ ka të drejtë të marrë një nismë për vënien në lëvizje të Gjykatës. Ndonëse statuti parashikon se kryetari zgjidhet për një mandat 1-vjeçar pa të drejtë riemërimi, rezulton se kryetari është i zgjedhur që prej datës 14.11.2019.

Kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, nuk legjitimohet për pretendimet e tij për cenimin e neneve 11, 49, 55 dhe 59 të Kushtetutës, pasi ato janë të drejta dhe liri të individit dhe jo të organizatës. Kërkuesi nuk legjitimohet as për pretendimet në lidhje me nenin 101 të saj, pasi është subjekt i kushtëzuar.

12.3 *Për themelin e pretendimeve*

12.3.1 Pretendimi për cenimin e *nenit 101 të Kushtetutës* është i pabazuar, pasi plotësohen kriteret e nevojës dhe të urgjencës. Këshilli i Ministrave u gjend përballë nevojës për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike, sikurse është kujdesi shëndetësor i garantuar nga nenet 55 dhe 59, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës dhe nevoja për parandalimin e menjëhershëm të spekulimeve. Rezultatet e një hetimi penal kanë ngritur dyshime për mosdhënien e shërbimeve mjekësore dhe dërgimin e pacientëve në struktura private dhe, në vijim, hetimi administrativ i kryer në strukturën spitalore konstatoi se mjekët nuk ishin të pranishëm gjatë orarit zyrtar në mjediset e punës. Nevoja për miratimin e aktit normativ konsiston në mungesën e rregullimit ligjor të ushtrimit të profesionit të mjekut në mënyrë të njëkohshme në sistemin shëndetësor publik dhe jopublik, faktin se legjislacioni për etikën nuk ka rezultuar efektiv dhe garantimin e kujdesit shëndetësor. Për sa i përket kriterit të urgjencës, ai u evidentua pas hetimit penal të datës 25.6.2024, i pasuar nga hetimi administrativ. Analiza e raporteve për gjendjen e sistemit shëndetësor kërkoi një periudhë kohore deri në paraqitjen e propozimit për aktin normativ. Ndjekja e procesit legjislativ do të kërkonte 3–9 muaj, ndërsa miratimi me procedurë të përshpejtuar do të pengohej nga mbyllja e sesionit parlamentar. Ndërhyrja urgjente është e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të shërbimit shëndetësor publik dhe abuzimin në ofrimin e këtij shërbimi. Pamundësia e mjekëve për të paraqitur kërkesë për të ushtruar profesionin në një institucion shëndetësor jopublik është e përkohshme, pasi lidhet me çastin e arritjes së statusit të autonomisë spitalore financiare.

12.3.2 Kërkuesja nuk ka ngritur asnjë problematikë të natyrës kushtetuese për pretendimin për cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës*, pasi nuk ka arritur të evidentojë asnjë shkelje kushtetuese, ndërkohë që ndërhyrja me ligj për të rregulluar aspekte funksionale të një institucioni të krijuar me ligj nuk përbën shkelje të Kushtetutës. Vende të ndryshme kanë pranuar rolin mbikëqyrës të organeve shtetërore për rregullimin e profesioneve shëndetësore. Ashpërsimi i masave disiplinore ndikon në rritjen e përgjegjësisë personale dhe llogaridhënien dhe nuk mund të arrihej me mjete të tjera.

Edhe pretendimi i kërkuesit tjetër, Urdhrit të Mjekëve, në drejtim të *parimit të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi ai është ent publik i krijuar me ligj dhe i nënshtrohet kontrollit dhe mbikëqyrjes më të theksuar nga organet publike, për të garantuar interesin publik dhe të drejtën për jetën dhe shëndetin. Roli i Ministrisë së Shëndetësisë në miratimin e Kodit Etik është instrument për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor. Pavarësia e funksionale dhe organizative nuk cenohen as nga dispozitat e aktit normativ për komisionet disiplinore, pasi ligjvënësi ka të drejtë të parashikojë një mekanizëm kontrolli

shtetëror si garanci shtesë për qytetarët dhe për vetë mjekët. Përbërja e komisioneve disiplinore forcon legjitimitetin dhe paanshmërinë e vendimmarrjes. Po kështu, pretendimi për cenimin e lirisë së organizimit u referohet shoqatave dhe organizatave që krijohen nga individët me vendim gjyqësor dhe jo Urdhrit të Mjekëve, që është ent i krijuar me ligj.

12.3.3 Pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, së drejtës për punë dhe ushtrimit të profesionit të lidhur me *parimin e proporcionalitetit* nuk qëndron, pasi kufizimi i së drejtës për punë ka respektuar kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Është objektivisht e pamundur që mjekët të jenë të punësuar me kohë të plotë njëkohësisht në institucionet shëndetësore publike dhe jopublike dhe e papajtueshme me legjislacionin aktual. Kufizimi i orëve të punës 30% është bërë me qëllim që mjekët të mos i neglizhojnë detyrat në sistemin publik. Ndërhyrja është bërë për interes publik, në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të qytetarëve, pasi në praktikë është evidentuar reduktimi i cilësisë në ofrimin e shërbimit shëndetësor si rezultat i mungesës së mjekëve gjatë orarit të punës. Po kështu, është respektuar kriteri i proporcionalitetit, pasi akti normativ ka për qëllim forcimin e disiplinës, llogaridhënies dhe eliminimin e konfliktit të interesit. Numri i procedimeve disiplinore ka qenë shumë i ulët ndër vite dhe legjislacioni nuk ka rezultuar efektiv. Akti normativ përmbush nënkriteret e nevojës, të domosdoshmërisë dhe të përshtatshmërisë. Ai nuk kufizon të drejtën e mjekëve që punojnë vetëm në sistemin shëndetësor publik, por rregullon situatën kur ata kërkojnë angazhimin edhe në sistemin jopublik. E drejta e ankimimit të vendimeve të Komisionit të Apelimit është një garanci e shtuar, ndërsa masat disiplinore përmbushin kriterin e proporcionalitetit dhe qëllimi i kërkuar nuk mund të arrihet me masa të tjera. Rregullimi i mënyrës së ushtrimit të profesionit të mjekut është i domosdoshëm me qëllim eficiencën në ofrimin e shërbimit.

12.3.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* është i pabazuar, pasi mjekët nuk janë në kushte objektivisht të njëjta me punonjësit e tjerë të shërbimit shëndetësor, si për sa u përket kualifikimeve të nevojshme, ashtu edhe peshës që ka shërbimi i tyre. Për këto kategori mund të parashikohen masa disiplinore të ndryshme. Pretendimi për diskriminimin e mjekëve të punësuar në strukturat me autonomi spitalore në raport me ata në strukturat publike nuk qëndron, pasi këto dy kategori janë në situata jo të njëjta, sepse të parat mund të sigurojnë më tepër të ardhura, duke ndikuar në rritjen e cilësisë së shërbimit.

12.3.5 Pretendimi i kërkuesit, Urdhrit të Mjekëve, për cenimin e së *drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi argumentet e parashtruara nuk kanë të bëjnë me qëllimin dhe përmbajtjen e nenit 42 të Kushtetutës, i cili nuk është i zbatueshëm për situatën konkrete. Kjo dispozitë kushtetuese lidhet me të drejtën e individit për proces të rregullt ligjor përpara gjykatave dhe jo me procedurat e brendshme parlamentare. Kërkuesi është njoftuar dhe i është dhënë mundësia për të shprehur qëndrimin e tij, ndërsa afatet e shkurtra lidhen me natyrën emergjente të aktit normativ.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

13. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se Gjykata nuk ka juridiksion të shqyrtojë aktin normativ, pasi ligjvënësi ka diskrecion të plotë që të vendosë për organizimin e profesioneve dhe çështja objekt shqyrtimi nuk përmban probleme të kushtetutshmërisë, por të raportit që duhet të kenë në zbatim norma me fuqi të njëjta juridike, të cilat nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

14. Nisur nga përmbajtja dhe thelbi i argumenteve të paraqitura nga subjektet e interesuara, Gjykata vëren se pretendimet e tyre nuk lidhen me kufijtë e juridiksionit të saj kushtetues, por kanë të bëjnë kryesisht me vlerësimin e përmbushjes së kritereve të legjitimimit të subjekteve kërkuese. Për këtë arsye, Gjykata çmon t'i trajtojë këto argumente në kuadër të analizës së legjitimimit *ratione materiae*.

B. Për legjitimimin e kërkuesve

15. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur (*shih vendimet nr. 43, datë 24.7.2025; nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

B.1 Për legjitimimin e kërkueses, Sindikatës

16. Kërkuesja ka pretenduar se legjitimohet, pasi është krijuar si organizatë sindikale kombëtare dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit. Sipas saj, akti normativ nr. 2/2024, si dhe ligji miratues prekin drejtpërdrejt interesat ekonomikë dhe shoqërorë të anëtarëve të Sindikatës që janë anëtarë të Urdhrit të Mjekëve dhe sjellin pasoja negative për të. Ajo ka pretenduar se legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet e saj. Konkretisht, për pretendimin e cenimit të nenit 101 të Kushtetutës kërkuesja ka pretenduar se legjitimohet, pasi Gjykata në vendimin nr. 1, datë 6.2.2013, ka legjitimuar një shoqatë në një rast të ngjashëm, akti normativ është çështje që prek interesin e drejtpërdrejtë të Sindikatës, si dhe cenon parimin e shtetit të së drejtës.

17. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesja nuk legjitimohet, pasi ajo është një organizëm që ka objekt të ndryshëm nga Urdhri i Mjekëve, pasi ky i fundit është një organizatë e krijuar me ligj, ndërsa kërkuesja është organizim vullnetar, pra ka anëtarësi dhe qëllime të ndryshme. Sipas tyre, kërkuesja nuk mund të kërkojë shfuqizimin e një ligji që rregullon veprimtarinë e një organizate tjetër vetëm për faktin se një pjesë e veprimtarisë së saj përfaqëson edhe anëtarë të organizatës tjetër. Po sipas subjekteve të interesuara, pretendimet për cenimin e neneve 11, 17, 49, 55 dhe 59 të Kushtetutës nuk lidhen me veprimtarinë e Sindikatës, por janë të drejta dhe liri të individit, potencialisht anëtarë të saj. Për sa kohë akti normativ nuk ka cenuar një të drejtë të lidhur me Sindikatën për shkak të shkeljeve procedurale të pretenduara, kërkuesja nuk legjitimohet. Po kështu, sipas subjekteve të interesuara, ajo (Sindikata) nuk legjitimohet *ratione personae* për pretendimin për cenimin e së drejtës së shtetasve për kujdes shëndetësor dhe për standardin më të lartë shëndetësor, të garantuara nga nenet 55 dhe 59, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës, pasi nuk provon interesin e saj të drejtpërdrejtë. Në drejtim të legjitimimit formal sipas tyre, mungon autorizimi për përfaqësuesin që të veprojë në emër dhe për llogari të Sindikatës dhe nuk rezulton se cili organ ka të drejtë të marrë një nismë për vënien në lëvizje të Gjykatës. Po kështu, kryetari i Sindikatës rezulton të jetë zgjedhur që në datën 14.11.2019, ndonëse statuti parashikon se ai ka një mandat 1-vjeçar.

18. Për legjitimimin e organizatave, sipas nenit 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit *(shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

19. Për sa i përket legjitimimit *ratione personae* në aspektin formal, Gjykata vëren se kërkuesja është person juridik i regjistruar me vendimin nr. 17, datë 14.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Organet drejtuese të saj janë kongresi, bordi drejtues, kryesia, kryetari dhe organet në nivel vendor. Sipas përmbajtjes së nenit 18 të statutit të saj, bordi drejtues është organi më i lartë vendimmarrës që drejton veprimtarinë e Sindikatës midis dy kongreseve, ndërsa referuar nenit 26, kryetari i Sindikatës zgjidhet dhe shkarkohet nga bordi drejtues për një mandat 1-vjeçar pa të drejtë rikandidimi dhe me sistem rotacioni. Kryetari është përfaqësuesi që menaxhon të gjithë aktivitetin e Sindikatës me të tretët. Sipas vërtetimit gjyqësor të datës 10.2.2025, rezulton se kryetar i Sindikatës është zoti Gentian Stroni, i cili nëpërmjet autorizimit të datës 15.11.2024, ka autorizuar përfaqësuesit ligjorë që të përfaqësojnë Sindikatën përpara Gjykatës për çështjen objekt kërkese.

20. Lidhur me prapësimet e subjekteve të interesuara se mungon autorizimi për kryetarin e Sindikatës për t'iu drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e aktit normativ, në praktikën e saj Gjykata nuk e ka vënë në dyshim legjitimitetin formal dhe procedural të shoqatave, pavarësisht se cili nga organet drejtuese ka marrë nismën për t'iu drejtuar Gjykatës (*shih vendimet nr. 35, datë 22.11.2022; nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, në aspektin formal kryetari i Sindikatës legjitimohet t'i drejtohet

Gjykatës pa qenë e nevojshme paraqitja e ndonjë akti të organeve të tjera për të provuar vullnetin e Sindikatës për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

21. Në lidhje me prapësimin tjetër se zoti Gentian Stroni është i vetmi kryetar i zgjedhur që prej datës 14.11.2019, ndonëse statuti parashikon se kryetari zgjidhet për një mandat 1-vjeçar pa të drejtë riemërimi, Gjykata vëren se referuar vërtetimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të datës 30.9.2025, kërkuesja, Sindikata, në kongresin e parë të saj të mbajtur në datën 18.4.2025, ka vendosur saktësimin e nenit 26 të statutit që ka të bëjë me kompetencat e kongresit për të zgjedhur kryetarin e Sindikatës për një mandat 5-vjeçar, si dhe rizgjedhjen e kryetarit, zotit Gentian Stroni. Në këtë kuptim, Gjykata e gjen të pabazuar prapësimin e subjekteve të interesuara.

22. Po kështu, Gjykata vëren se në mbështetje të prapësimeve të tyre, subjektet e interesuara kanë referuar edhe vendimin nr. 21, datë 28.4.2021, të kësaj Gjykate, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për shkak të mungesës së legjitimimit të organit përfaqësues të shoqatës kërkuese, të cilit i kishte mbaruar mandati. Gjykata evidenton se në atë çështje konstatoi mungesën e legjitimimit të përfaqësimit të shoqatës kërkuese, pasi jo vetëm kishte kaluar një periudhë shumë e gjatë kohore në të cilën organi përfaqësues kishte vepruar në mungesë të mandatit të dhënë, por edhe se gjatë kësaj periudhe shoqata kishte zgjedhur një kryetar tjetër, i cili e kishte përfaqësuar atë në marrëdhënie me të tretët. Duke mbajtur në konsideratë faktin se në rastin konkret, kryetari Gentian Stroni është rizgjedhur në datën 18.4.2025 dhe ka përfaqësuar Sindikatën në seancën plenare publike të zhvilluar për këtë gjykim kushtetues, Gjykata vlerëson se ai vendim i saj nuk gjen zbatim në rastin konkret.

23. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë shkak për të vënë në dyshim materializimin e vullnetit të Sindikatës dhe tagrat e përfaqësimit në këtë gjykim, ndaj pretendimi i subjekteve të interesuara, për mungesën e legjitimimit formal të kërkueses, është haptazi i pabazuar.

24. Ndërsa në lidhje me aspektin substancial, Gjykata vëren se, sipas statutit, Sindikata është krijuar me bashkimin vullnetar të punonjësve të shërbimit shëndetësor ku përfshihen mjekë, stomatologë, farmacistë etj., si dhe çdo punonjës që shërben në shërbimin shëndetësor (*neni 1*). Ajo është një organizatë sindikale profesionale, shoqërore që përfaqëson interesat ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të saj, të punëmarrësve të sektorëve shëndetësorë që ajo përfaqëson (*neni 3*). Referuar nenit 11, kërkuesja përfaqëson dhe mbron drejtpërdrejt interesat dhe të drejtat në punë të anëtarëve të saj përpara institucioneve shtetërore ose subjekteve private, si dhe në raport me pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Sipas nenit 6 të aktit të themelimit, objekti i aktivitetit të Sindikatës është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të saj dhe të punëmarrësve të sistemit shëndetësor. Anëtarët themelues të saj janë 25 shtetas shqiptarë me profesionin "mjek".

25. Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *parimit të shtetit të së drejtës,* pasi akti normativ cenon pavarësinë dhe vetërregullimin e Urdhrit të Mjekëve. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vë në dukje se dispozitat ligjore të kundërshtuara u drejtohen Urdhrit të Mjekëve si ent publik jobuxhetor i krijuar me ligj, cilësi që kërkuesja si sindikatë nuk rezulton ta gëzojë. Për këtë shkak, sikurse ka prapësuar subjekti i interesuar, Gjykata çmon se ndonëse një pjesë e anëtarëve të Sindikatës janë njëkohësisht edhe anëtarë të Urdhrit të Mjekëve, kërkuesja nuk ka arritur të provojë të drejtën e cenuar nga akti normativ dhe interesin e ligjshëm vetjak të saj. Për rrjedhojë, ajo nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për këtë pretendim.

26. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e *së drejtës për kujdes shëndetësor dhe për standardin më të lartë shëndetësor,* të garantuara nga nenet 55 dhe 59 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të provojë interesin e saj të drejtpërdrejtë, për sa kohë ato janë të drejta vetjake që lidhen me individin dhe jo me Sindikatën si organizatë dhe qëllimin e saj për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj, të punëmarrësve të sektorëve shëndetësorë. Anëtarët e Sindikatës nuk paraqiten në këtë gjykim thjesht si individë, por në cilësinë e mjekut, për rrjedhojë ata nuk janë titullarë të këtyre të drejtave. Ndërsa për pretendimet e tjera kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, pasi ka justifikuar interesin e saj në çështjen në shqyrtim.

27. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2

vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit. Akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 2/2024, ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 139, datë 7.8.2024. Më pas, ky akt normativ me fuqinë e ligjit është miratuar me ligjin nr. 94/2024 të Kuvendit, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 176, datë 18.10.2024. Kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 18.12.2024, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar, ndaj kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis* për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

28. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar se akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 2/2024 dhe ligji miratues i saj nr. 123/2014 kanë cenuar nenin 101 të Kushtetutës për shkak të mungesës së nevojës, urgjencës dhe marrjes së masave të përkohshme në nxjerrjen e aktit të kundërshtuar, lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën për punë të lidhur me parimin e proporcionalitetit, si dhe parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, të garantuara nga nenet 11, 17, 18 dhe 49 të saj.

29. Lidhur me pretendimin për *cenimin e nenit 101 të Kushtetutës*, sipas të cilit akti normativ nuk është miratuar në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, pasi mungon ngjarja e jashtëzakonshme që ka sjellë nevojën e miratimit dhe dypunësimi i mjekëve është fenomen 20- vjeçar, pra nuk justifikohet urgjenca në miratimin e tij, në përfundim të diskutimeve Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

30. Kështu, sipas njërit qëndrim, u vlerësua se subjektet e kushtëzuara legjitimohen për të kundërshtuar procedurën për miratimin e ligjit vetëm nëse dispozitat ligjore të kundërshtuara cenojnë ndonjë të drejtë themelore të garantuar nga Kushtetuta.[4] Sipas qëndrimit tjetër, u vlerësua se Gjykata vlerëson edhe pretendimet me natyrë procedurale, pra procedurën për miratimin e ligjeve dhe të akteve të tjera normative, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja "c", të Ligjit Organik të Gjykatës, për sa kohë kërkuesi që vë në lëvizje gjykimin kushtetues justifikon interesin vetjak në çështjen e parashtruar dhe ngre pretendime substanciale me natyrë kushtetuese, pavarësisht nëse gjatë shqyrtimit të themelit të çështjes ato mund të rezultojnë të pabazuara.[5] Ndërsa sipas qëndrimit të tretë, u vlerësua se pretendimet me natyrë procedurale të ngritura nga subjektet e kushtëzuara nuk mund t'i nënshtrohen juridiksionit kushtetues.[6] Duke mbajtur në konsideratë kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje dhe qëndrimet e gjyqtarëve, Gjykata do t'i trajtojë në themel pretendimet për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës në rast se do të konstatojë cenimin e të drejtave dhe lirive të pretenduara nga kërkuesit.

31. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të kërkueses për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe së drejtës për punë të lidhur me parimin e proporcionalitetit, si dhe parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, Gjykata çmon se kërkuesja legjitimohet *ratione materiae* dhe këto pretendime bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, prandaj do të trajtohen në vijim në themel.

B.2 Për legjitimimin e kërkuesit, Urdhrit të Mjekëve

32. Kërkuesi ka parashtruar se legjitimohet, pasi është person juridik i krijuar me ligj si ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit të Mjekut dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut. Ai ka pretenduar se ka interes real për mbrojtjen e standardeve kushtetuese të funksionimit të profesionit të mjekut në mënyrë cilësore dhe të pavarur. Po kështu, sipas tij, përmbushet edhe kriteri i legjitimimit *ratione materiae,* pasi pretendimet janë me natyrë kushtetuese, ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, për sa kohë kërkuesi ka legjitimitet të kushtëzuar, Gjykata ushtron kontrollin kushtetues vetëm nëse provohet shkelje e të drejtave subjektive.

33. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimet që lidhen me cenimin e neneve 11, 49, 55 dhe 59 të Kushtetutës, pasi ato janë të drejta dhe liri të individit dhe jo të organizatës. Sipas tyre, kërkuesi nuk legjitimohet as për pretendimet për nenin 101 të Kushtetutës, pasi është subjekt i kushtëzuar.

[4] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Marjana Semini.

[5] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Sonila Bejtja.

[6] Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Holta Zaçaj dhe gjyqtarët Ilir Toska e Genti Ibrahimi.

34. Gjykata vëren se referuar ligjit nr. 123/2014, Urdhri i Mjekëve është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut (*neni 3*). Organet kryesore të tij janë asambletë, këshillat dhe presidentët (*neni 11*). Ndërsa sipas statutit, Asambleja Kombëtare është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës, e cila zgjedh Këshillin Kombëtar *(neni 15*). Ky i fundit zgjedh Presidentin e Urdhrit të Mjekëve me mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë (*neni 16*). Presidenti i Këshillit Kombëtar në kuadër të marrëdhënieve me institucionet e administratës shtetërore, si dhe organizma të tjera brenda dhe jashtë vendit, përfaqëson Këshillin Kombëtar dhe shprehet në emër të tij (*neni 20*).

35. Me vendimin nr. 1, datë 30.8.2024, Asambleja e Përgjithshme e Urdhrit të Mjekëve ka autorizuar Këshillin Kombëtar dhe drejtuesit e tij ta dërgojnë çështjen në Gjykatë. Presidenti i Këshillit Kombëtar, zoti Fatmir Brahimaj (i zgjedhur me vendimin nr. 1, datë 26.6.2020), ka autorizuar përfaqësuesit ligjorë të përfaqësojnë Urdhrin e Mjekëve për të kundërshtuar në Gjykatë aktin normativ nr. 2/2024 dhe VKM-në nr. 85/2025. Gjatë gjykimit të çështjes, kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, ka paraqitur vendimin nr. 1, datë 25.4.2025, sipas të cilit, zoti Dritan Trepça është zgjedhur në detyrën e Presidentit të Këshillit Kombëtar dhe e ka përfaqësuar kërkuesin në seancë plenare. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në aspektin formal.

36. Ndërsa në lidhje me aspektin substancial, sipas statutit, Gjykata vëren se Urdhri i Mjekëve përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut (*neni 2*). Anëtarë të tij janë të gjithë mjekët, mjekët e specializuar që ushtrojnë profesionin në sistemin shëndetësor publik dhe privat dhe anëtarësimi është parakusht për ushtrimin e profesionit (*neni 3*). Misioni i tij është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të mjekut, si dhe mbron të drejtat e anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve (*neni 4*).

37. Në referim të këtyre parashikimeve, Gjykata vëren se, për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për kujdes shëndetësor*, të garantuar nga neni 55 i Kushtetutës, sikurse theksoi edhe për kërkuesen tjetër, Sindikatën, kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, nuk legjitimohet *ratione personae,* pasi nuk provon interesin e drejtpërdrejtë, në kushtet kur kjo e drejtë i përket individit dhe jo Urdhrit të Mjekëve, si ent publik, i cili ka për qëllim të përfaqësojë interesat e anëtarëve të tij, pra të mjekëve, të cilët nuk janë titullarë të kësaj të drejte. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, duke mbajtur në konsideratë qëllimin e veprimtarisë së kërkuesit, anëtarësinë e tij dhe natyrën e pretendimeve të parashtruara në kërkesë, që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së Urdhrit të Mjekëve, kërkuesi provon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, ndaj legjitimohet edhe në aspektin substancial për t'iu drejtuar Gjykatës.

38. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 26.5.2025, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit që ka miratuar aktin normativ nr. 2/2024 (datë 18.10.2024) dhe VKM-së nr. 85/2025 (datë 10.2.2025).

39. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se akti normativ me fuqinë e ligjit nr. 2/2024 dhe VKM-ja nr. 85/2025 kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, lirinë e organizimit të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe shtetit të së drejtës, lirinë e veprimtarisë ekonomike, të drejtën për të ushtruar profesionin të lidhur me parimin e proporcionalitetit, si dhe nenin 101 të Kushtetutës.

40. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, kërkuesi ka argumentuar se kjo e drejtë gjen zbatim edhe në procesin legjislativ dhe atij nuk i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur brenda një kohe të arsyeshme gjatë procesit ligjvënës. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi neni 42 i Kushtetutës që parashikon të drejtën për proces të rregullt nuk është i zbatueshëm për situatën konkrete. Sipas tyre, kjo dispozitë kushtetuese lidhet me të drejtën e individit për proces të rregullt ligjor përpara gjykatave dhe jo me procedurat e brendshme parlamentare. Kërkuesi është njoftuar dhe i është dhënë mundësia për të shprehur qëndrimin e tij, ndërsa afatet e shkurtra lidhen me natyrën emergjente të aktit normativ.

41. Mbështetur në argumentet e kërkuesit, Gjykata e gjen të bazuar prapësimin e subjekteve të interesuara dhe konstaton se pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim nuk lidhet me procesin e rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por me procedurën parlamentare të konsultimit publik të akteve. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata vëren se kërkuesi ka qenë i pranishëm në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe koha e pamjaftueshme për t'u përgatitur për projektaktin nuk përbën në vetvete argument kushtetues në mbështetje të pretendimit të kërkuesit, për rrjedhojë ai është haptazi i pabazuar.

42. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e nenit 101 të Kushtetutës*, Gjykata me të njëjtin arsyetim si në rastin e kërkueses tjetër, Sindikatës (*shih paragrafin 30 të vendimit*) dhe duke mbajtur në konsideratë se edhe kërkuesi Urdhri i Mjekëve është një subjekt i kushtëzuar, do të vijojë me analizën e këtij pretendimi në themel në rast se do të konstatojë cenimin e të drejtave dhe të lirive të pretenduara nga kërkuesi. Ndërsa për pretendimet e tjera, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione materiae.*

43. Gjithashtu, pretendimet për cenimin e lirisë së organizimit, parimit të sigurisë juridike dhe parimit të shtetit të së drejtës, në kushtet kur argumentet e kërkuesit, Urdhri i Mjekëve kanë të bëjnë me organizimin dhe vetërregullimin e tij, Gjykata çmon t'i analizojë ato në drejtim të parimit të shtetit të së drejtës.

44. Lidhur me pretendimet që kërkuesit kanë ngritur në mënyrë të përbashkët për *cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, së drejtës për punë dhe të lirisë së ushtrimit të profesionit* të lidhur me *parimin e proporcionalitetit,* të garantuara nga nenet 11, 17 dhe 49 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje se në thelb, pretendimet e tyre janë përqendruara mbi dy shkaqe kryesore: i. kufizimi i së drejtës së mjekëve për të mos punuar në sistemin shëndetësor jopublik më shumë se 30 % të orëve mujore që punon në sistemin shëndetësor publik së bashku me detyrimin e mjekut që të marrë leje nga titullari i institucionit shëndetësor publik për të ushtruar profesionin në një institucion privat; ii. ashpërsimi i masave disiplinore, veçanërisht ajo që lidhet me heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit në mënyrë të përhershme në aspektin e paqartësisë së normës dhe faktit se mosshuarja e masës disiplinore cenon thelbin e së drejtës për të ushtruar profesionin e mjekut. Nisur nga kjo, Gjykata çmon të analizojë shkakun e parë në drejtim të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe shkakun e dytë në drejtim të së drejtës për punë dhe ushtrimin e një profesioni, secila në raport me parimin e proporcionalitetit, të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, Gjykata çmon ta analizojë në themel të lidhur me lirinë e veprimtarisë ekonomike.[7]

C. Për themelin e pretendimeve

C.1 Për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës

45. Kërkuesi, Urdhri i Mjekëve, ka pretenduar se akti normativ nr. 2/2024 dhe VKM-ja nr. 85/2025 cenojnë vetërregullimin e Urdhrit të Mjekëve si ent i pavarur, i cili duhet të ketë autonomi nga Ministria e Shëndetësisë, duke dobësuar pavarësinë organizative dhe funksionale në drejtim të kompetencës së Ministrisë së Shëndetësisë për të miratuar Kodin e Etikës dhe mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të komisioneve të disiplinës dhe të apelimit, për shkak se ky i fundit do të funksionojë pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

46. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet për këtë pretendim, pasi është një ent publik i krijuar me ligj dhe i nënshtrohet kontrollit dhe mbikëqyrjes më të theksuar nga organet publike, për të garantuar interesin publik dhe të drejtën për jetën dhe shëndetin. Sipas tyre, roli i Ministrisë së Shëndetësisë në miratimin e Kodit Etik është instrument për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor. Sipas subjekteve të interesuara, pavarësia funksionale dhe organizative nuk cenohet as nga dispozitat e VKM-së për komisionet disiplinore, pasi ligjvënësi ka të drejtë të parashikojë një mekanizëm kontrolli shtetëror si garanci shtesë për qytetarët dhe për vetë mjekët. Përbërja e komisioneve disiplinore forcon legjitimitetin dhe paanshmërinë e vendimmarrjes.

47. Gjykata ka vlerësuar se parimi i shtetit të së drejtës është një nga parimet më themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Ky parim është një normë e pavarur kushtetuese, shkelja e së cilës përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për

[7] Gjyqtarja Marjana Semini vlerësoi se pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit duhej të trajtohej në themel i ndarë nga pretendimet e tjera.

deklarimin e një ligji si antikushtetues (*shih vendimet nr. 7, datë 12.3.2010; nr. 20, datë 9.7.2009; nr. 20, datë 11.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se shteti i ushtron funksionet e tij jo vetëm nëpërmjet një sistemi institucionesh shtetërore por, në një farë mase, edhe nëpërmjet organizimeve të tjera joshtetërore, të cilave u besohet me ligj ushtrimi i funksioneve publike të caktuara. Ajo ka pranuar se profesione të tilla, ndaj të cilave shteti ushtron një mbikëqyrje të kufizuar, nënkuptojnë vetërregullimin e profesionit përkatës, vetërregullim që përfshin të gjithë profesionin dhe siguron, mes të tjerave, përfaqësimin e këtij profesioni në marrëdhëniet me shtetin dhe institucionet e vetërregulluara. Pa garantimin e një sistemi të tillë vetërregullimi dhe vetëqeverisjeje, delegimi i funksioneve përkatëse në duart e individit privat do të ishte i pajustifikueshëm nga pikëpamja kushtetuese (*shih vendimin nr. 7, datë 12.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese).*

48. Në respektim të këtij standardi, Gjykata ka pranuar se pavarësia dhe autonomia e disa enteve publike të krijuara me ligj nga këndvështrimi i parimit të shtetit të së drejtës ka vlerë kushtetuese. Të tillë ajo ka konsideruar shërbimin e avokatisë, duke vlerësuar se ai luan një rol të rëndësishëm për të garantuar shtetin e së drejtës, si dhe për të siguruar një mbrojtje eficiente të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se ndonëse ligjvënësit i lejohet të rregullojë profesionin e avokatit për interes publik, ndërhyrja nuk duhet të cenojë autonominë e profesionit, konkretisht autonominë financiare/buxhetore (*shih vendimin nr. 7, datë 12.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Ndërsa, në dallim me sa më sipër, për sa i përket profesionit të noterisë, Gjykata është shprehur se funksioni i noterit në thelb është një funksion publik i "deleguar", qëllimi i të cilit është që të realizohet një shërbim i pavarur, i paanshëm e profesional. Parashikimi me ligj i funksioneve mbikëqyrëse të këtij profesioni nga shteti është bërë me qëllim garantimin e parametrave të besueshmërisë së noterëve në ushtrimin e drejtë të autoritetit që u është deleguar nga shteti dhe kontrolli shtetëror nuk është antikushtetues për sa kohë është i lidhur me kontrollin e respektimit të funksionit që u është deleguar noterëve dhe që shprehet në vlerën që kanë dokumentet e tyre *(shih vendimin nr. 3, datë 19.1.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe për sa i përket profesionit të ekspertit kontabël, Gjykata ka pohuar se ai është një funksion publik i shtetit i deleguar dhe, për rrjedhojë, mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre nuk mund të jetë e pakontrolluar dhe e lirë nga çdo lloj rregullimi ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 5.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Gjykata paraprakisht vëren se Urdhri i Mjekëve nuk përfshihet në rrethin e organeve të parashikuara nga Kushtetuta. Ai përfaqëson një ent publik jobuxhetor, profesional dhe të pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve dhe rregullon veprimtaritë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut. Megjithatë, bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura, Urdhri i Mjekëve ndonëse është një person juridik i së drejtës publike i krijuar me ligj, ushtron kompetenca që ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e objektivave socialë të shtetit në fushën e shëndetësisë, siç përcaktohet në nenin 59 të Kushtetutës, çka do të thotë se ai ushtron funksion të një natyre publike, prandaj edhe ndaj tij duhet të garantohet një sistem vetërregullimi dhe vetëqeverisjeje.

51. Nëpërmjet aktit normativ të kundërshtuar është parashikuar se komisionet disiplinore (Komisioni i Disiplinës dhe Komisioni i Apelimit) ushtrojnë procedimin disiplinor. Ndërsa i pari funksionon pranë Urdhrit të Mjekëve dhe realizon shqyrtimin e ankesave, hetimin administrativ dhe, në rast konstatimi të shkeljeve, cakton me vendim masat disiplinore, i dyti ngrihet pranë Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësinë. Ndërsa sipas VKM-së nr. 85/2025 Komisioni i Disiplinës funksionon pranë Urdhrit të Mjekëve dhe përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 1 përfaqësues emërohet nga Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë, kurse Komisioni i Apelimit ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 përfaqësues zgjidhen nga Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë. Gjithashtu, sipas aktit normativ, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve harton Kodin e Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës të Shëndetësisë.

52. Gjykata konstaton se sipas parashikimit të mëparshëm nënligjor, komisionet disiplinore përbëheshin vetëm nga anëtarë të zgjedhur nga këshilli rajonal ose këshilli kombëtar i Urdhrit të Mjekëve, ndërsa Kodi i Etikës hartohej dhe miratohej nga Këshilli Kombëtar. Kjo do të thotë se

në organizimin e mëparshëm nuk kishte përfaqësues nga ministria përgjegjëse për shëndetësisë, pra nga ekzekutivi, porse funksionimi dhe organizimi i brendshëm ka qenë tërësisht nën autoritetin e vet Urdhrit të Mjekëve.

53. Në kuptim të standardeve të sipërcituara dhe në analizë të rrethanave të rastit konkret, Gjykata çmon se përfshirja e ministrisë përkatëse në organizimin dhe funksionimin e komisioneve të disiplinës të Urdhrit të Mjekëve, si dhe në procesin e miratimit të Kodit të Etikës, përbën një masë të arsyeshme dhe proporcionalisht të justifikuar të mbikëqyrjes shtetërore. Kjo ndërhyrje gjen mbështetje në natyrën publike të funksionit që ushtron Urdhri i Mjekëve (*shih paragrafin 50 të vendimit*). Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se detyrimi kushtetues i shtetit për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të shtetasve legjitimon rolin e ministrisë përgjegjëse në garantimin e respektimit të standardeve etike dhe profesionale në ushtrimin e profesionit të mjekut. Për rrjedhojë, pjesëmarrja e përfaqësuesve të kësaj ministrie në komisionet disiplinore dhe roli mbikëqyrës në procesin e miratimit të Kodit të Etikës nuk cenon pavarësinë funksionale të Urdhrit të Mjekëve, por synon të krijojë një ekuilibër ndërmjet autonomisë profesionale dhe përgjegjësisë publike në mbrojtje të interesit publik.[8]

54. Gjykata thekson gjithashtu se autonomia dhe pavarësia e Urdhrit të Mjekëve nuk përjashton ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse të shtetit në fushat ku realizohet një interes publik. Pavarësia e Urdhrit të Mjekëve ka për qëllim të sigurojë vetërregullimin e profesionit të mjekut, por ajo nuk mund të interpretohet si një imunitet ndaj kontrollit të ligjshmërisë, etikës dhe standardeve të cilësisë në ofrimin e kujdesit shëndetësor. Për më tepër, Gjykata evidenton se ligjvënësi nuk ka hequr ose transferuar në mënyrë të plotë kompetencat e Urdhrit të Mjekëve në fushën disiplinore ose në përcaktimin e rregullave të etikës profesionale, por ka parashikuar një formë ndërveprimi institucional që garanton transparencë dhe llogaridhënie në ushtrimin e funksioneve. Përfshirja e anëtarëve nga ministria përgjegjëse përkrah atyre të Urdhrit të Mjekëve në përbërjen e komisioneve disiplinore, të cilët janë në pakicë në raport me anëtarët e Urdhrit të Mjekëve, synon të parandalojë abuzimet dhe konfliktet e interesit që mund të cenojnë besimin publik ndaj profesionit të mjekut. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se organizimi i miratuar nga akti normativ objekt kundërshtimi nuk përbën ndërhyrje të pajustifikuar në autonominë e Urdhrit të Mjekëve, por është një mekanizëm kontrolli që i shërben zbatimit të detyrimeve kushtetuese të shtetit në mbrojtje të sigurimit të standardeve të larta shëndetësore.

55. Thënë kjo, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të shtetit të së drejtës është i pabazuar, për rrjedhojë edhe pretendimet që lidhen me VKM-në nr. 85/2025, e cila rregullon mënyrën e funksionimit të komisioneve disiplinore janë, të pabazuara.

C.2 Për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit

56. Kërkuesit kanë pretenduar se akti normativ ka ndaluar dypunësimin për anëtarët e Urdhrit të Mjekëve të punësuar në një institucion shëndetësor publik, që ka përfituar statusin e autonomisë spitalore financiare, kufizim i cili do të zgjasë pa afat dhe ka si qëllim ndalimin tërësisht të dypunësimit në vitin 2026. Sipas tyre ky parashikim ka ometuar: i. mundësinë e mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës ekskluziv ose joekskluziv; ii. trajtimin me pagesë suplementare për mjekët që zgjedhin raport pune ekskluziv me strukturën spitalore publike. Gjithashtu sipas kërkuesve detyrimi për të punuar jo më shumë se 30 % të orëve mujore në sistemin publik nuk mund të arrijë qëllimin e kërkuar që mjekët të respektojnë orarin e punës dhe ky kufizim nuk ndikon as në shmangien e interesit si dhe nuk është argumentuar apo bazuar në ndonjë studim specifik. Po kështu, kërkuesit kanë pretenduar se kufizimi i punësimit në sektorin privat në 30% të orëve mujore ka fuqi prapavepruese dhe nuk janë parashikuar dispozitat tranzitore duke u dëmtuar planet e aktivitetit ekonomik të mjekëve dhe pa marrë parasysh kreditë apo detyrimet financiare të tyre. Sipas kërkuesve, këto të drejta cenohen edhe nga neni 5 i aktit normativ që ka shtuar nenin 8/a të ligjit në lidhje me kushtet dhe procedurën që duhet të ndjekë një mjek i cili kërkon

[8] Në lidhje me miratimin e Kodit të Etikës gjyqtarja Marjana Semini mbajti qëndrimin se ndërhyrja e ministrisë përkatëse përbën një masë joproporcionale, prandaj pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është i bazuar.

të ushtrojë profesionin në një institucion shëndetësor jopublik. Po sipas tyre, akti normativ diskriminon: i. mjekët në raport me profesionet e tjera të rregulluara; ii. mjekët që punojnë në strukturat universitare me autonomi spitalore në raport me kolegët e tjerë që punojnë në struktura të tjera publike, si dhe iii. mjekët që punojnë në strukturat shëndetësore me autonomi spitalore dhe që do të lejohen të ushtrojnë dypunësimin në raport me kolegët e tjerë që punojnë në të njëjtën strukturë, por nuk lejohen të ushtrojnë dypunësim.

57. Sipas subjekteve të interesuara, mjekëve nuk u ndalohet të punojnë me kohë të plotë në qendrat shëndetësore publike apo private, ndërsa pretendimi se ata mund të punojnë 16 orë në ditë nuk gjen mbështetje ligjore. Akti normativ përmbush kriterin e kufizimit vetëm me ligj, është miratuar për një interes publik me qëllim mbrojtjen e të drejtës për kujdes shëndetësor dhe atë të proporcionalitetit. Sipas tyre argumentet e kërkuesve nuk janë kushtetuese, pasi zgjedhjet politike të ekzekutivit dhe ligjvënësit nuk mund të diskutohen në mënyrë gjyqësore. Akti normativ nuk i ka ndaluar mjekët të punojnë me kohë të plotë në qendrat shëndetësore publike apo jopublike. Ai i le të lirë të zgjedhin nëse duan të punojnë në qendra shëndetësore publike ose private me kohë të plotë dhe kufizimi i orëve të punës 30% është bërë me qëllim që mjekët të mos i neglizhojnë detyrat në sistemin publik. Sipas subjekteve të interesuara, ndërhyrja është bërë për interes publik, në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të qytetarëve, pasi në praktikë është evidentuar reduktimi i cilësisë në ofrimin e shërbimit shëndetësor si rezultat i mungesës së mjekëve gjatë orarit të punës. Subjektet e interesuara kanë parashtruar se për sa i përket pretendimit të kërkueses për pamundësinë e mjekëve që punojnë në strukturat spitalore me autonomi të plotë financiare të zgjedhin midis raportit të punës ekskluziv ose joekskluziv, ligji nr. 55/2022 ka parashikuar se kur një spital arrin autonomi të plotë spitalore, marrëdhënia e punësimit do të rregullohet nga vetë spitali, dhe jo nga ligji nr. 123/2014. Edhe pretendimi për mungesën e parashikimit të kontratave ekskluzive dhe joekskluzive, sipas subjekteve të interesuara, është i pabazuar, pasi ato materializohen në ligjin nr. 55/2022 i cili nuk është objekt kontrolli në këtë gjykim kushtetues. Argumentet e kërkueses janë hipotetike dhe i përkasin periudhës pas vitit 2026 e në vijim. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, subjektet e interesuara kanë prapësuar se ai është i pabazuar pasi mjekët nuk janë në kushte objektivisht të njëjta me punonjësit e tjerë të shërbimit shëndetësor dhe as me mjekët e punësuar në strukturat me autonomi spitalore në raport me ata në strukturat publike.

58. Neni 11 i Kushtetutës parashikon parimin themelor se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se kjo liri përmban në vetvete edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, lirinë monetare si masë për të garantuar qëndrueshmërinë e çmimit, lirinë fiskale për të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror ose lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti *(shih vendimet nr. 21, datë 18.4.2023; nr. 86, datë 30.12.2016; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë drejtim, ajo ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike përfshin edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet legjislacionit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Në këtë rast shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër (*shih vendimet nr. 56, datë 16.7.2024; nr. 60, datë 31.7.2017; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar gjithashtu se parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë *(shih vendimet nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 27, datë 29.6.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

60. Gjykata e ka vlerësuar cenimin ose jo të lirive dhe të drejtave kushtetuese duke iu referuar

përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës. Kjo dispozitë, përveç arsyes publike, përmban detyrimin për të respektuar edhe kritere të tjera, si: kufizimi për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë. Parimi i njohur i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte apo lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që u përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet *(shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2024; nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Sikurse u analizua më sipër (*shih paragrafin 44 të vendimit*), Gjykata në vijim do të trajtojë këtë pretendim të kërkuesve në dy aspekte: i. kufizimi i së drejtës së mjekëve për të mos punuar në sistemin shëndetësor jopublik më shumë se 30 % të orëve mujore që punon në sistemin shëndetësor publik; dhe ii. detyrimin e mjekëve që të marrin leje nga titullari i institucionit shëndetësor publik për të ushtruar profesionin në një institucion shëndetësor privat.

C.2.1 Për kufizimin 30% të orëve mujore

62. Gjykata vëren se neni 4 i aktit normativ ka ndryshuar nenin 8, të ligjit nr. 123/2014, duke shtuar në detyrimet e anëtarit të Urdhrit të Mjekëve, ndër të tjera, edhe detyrimin "*të mos punojë në sistemin shëndetësor jopublik më shumë se 30 për qind të orëve mujore, që punon në sistemin shëndetësor publik*".

63. Për sa i përket këtij pretendimi, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, ndërsa vlerësoi se kufizimi prej 30% përbën ndërhyrje të vendosur me ligj dhe për interes publik, në lidhje me proporcionalitetin e masës, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

64. Kështu, sipas njërit qëndrim, kufizimi prej 30%, i lidhur me faktin se aplikohet vetëm ndaj mjekëve që punojnë në sistemin shëndetësor publik, përbën ndërhyrje të pajustifikuar në lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe trajtim jo të barabartë të tyre, pasi është miratuar në mungesë të një analize të qartë të nevojës dhe domosdoshmërisë për mbrojtjen e interesit publik dhe pa u mbështetur në kritere objektive, duke cenuar edhe parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit. Subjektet e interesuara nuk kanë arritur të provojnë proporcionalitetin e këtij kufizimi dhe po kështu nuk kanë dhënë ndonjë argument as për trajtimin ndryshe të kësaj kategorie të mjekëve, ndonëse barra e provës në këtë drejtim u përket autoriteteve shtetërore. Thënë kjo, nuk ekziston ndonjë arsye që të përligjë trajtimin e ndryshëm të tyre. Duke mbajtur në konsideratë situatën aktuale të numrit të përgjithshëm të mjekëve dhe prirjes së tyre për t'u larguar nga vendi, arrihet në përfundimin se shteti ka mjete të tjera më pak kufizuese për të garantuar përmbushjen e detyrimeve të mjekëve në sistemin shëndetësor publik, si forcimi i masave mbikëqyrëse dhe disiplinore, mjete të cilat janë në raport të drejtë me qëllimin legjitim për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të individëve.[9]

65. Sipas qëndrimit tjetër, kufizimi prej 30% i përcaktuar nga ligjvënësi nuk përbën ndërhyrje në lirinë e veprimtarisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës, pasi ajo nuk është e ashpër në kuptimin që të cenojë thelbin e kësaj të drejte. Duke mbajtur në vëmendje rëndësinë e shërbimit shëndetësor publik, ky kufizim përbën një masë të arsyeshme, proporcionale dhe të justifikuar nga interesi publik që i jep përparësi shërbimit publik me qëllim mbrojtjen e të drejtës kushtetuese të individëve për kujdes shëndetësor cilësor. Nga ana tjetër, kufizimi prej 30% synon parandalimin e orëve të gjata të punës që cenojnë cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e pacientit, ndërkohë që kjo kategori profesionistësh nuk përbën grup vulnerabël dhe u jepet zgjedhja e lirë për të ushtruar veprimtarinë në sektorin shëndetësor publik ose privat.[10] Gjithashtu ky kufizim nuk cenon parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, pasi trajtimi i ndryshëm i mjekëve justifikohet nga natyra specifike e profesionit të tyre, niveli i përgjegjësisë dhe nevoja për të garantuar interesin publik dhe jetën e individëve, duke u mbështetur në kritere objektive dhe proporcionale.[11]

[9] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci

[10] Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Holta Zaçaj dhe gjyqtarët Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi e Marjana Semini.

[11] Votuan sipas këtij qëndrimi Kryetarja Holta Zaçaj dhe gjyqtarët Sonila Bejtja e Genti Ibrahimi, ndërsa gjyqtarja Marjana Semini e shqyrtoi pretendimin për cenimin e parimit të mosdiskriminimit të lidhur me mënyrën potencialisht të ndryshme të trajtimit të mjekëve brenda vetë institucioneve shëndetësore me autonomi financiare, për sa i përket marrjes së autorizimit të titullarit për të ushtruar profesionin e mjekut në një institucion shëndetësor jopublik.

66. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, pretendimi për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike për shkak të kufizimit 30% konsiderohet i rrëzuar.

C.2.2 Për detyrimin për t'i bërë kërkesë titullarit për të ushtruar profesionin e mjekut në një institucion shëndetësor jopublik

67. Gjykata vëren se neni 8/a, i ligjit nr. 123/2014 ka përcaktuar kushtet dhe procedurat që një mjek në një institucion shëndetësor publik mund të ushtrojë profesionin në një institucion shëndetësor jopublik. Kështu sipas pikës 1 të këtij neni, një anëtar i Urdhrit të Mjekëve, që kërkon të ushtrojë profesionin e mjekut në një institucion shëndetësor jopublik, duhet t'i bëjë kërkesë titullarit të institucionit shëndetësor publik, ku ai është i punësuar, ndërsa anëtarët të cilët janë punësuar në një institucion shëndetësor publik, që ka përfituar statusin e autonomisë spitalore financiare, nuk mund të bëjnë kërkesë sipas kësaj pike *(pika 3)*. Titullari i institucionit vlerëson: a) ngarkesën e orëve që mjeku ushtron në institucionin shëndetësor publik; b) mbulimin e shërbimit nga personeli tjetër mjekësor në institucionin shëndetësor publik; c) mundësinë e konfliktit të interesit *(pika 5)*. Në rast se titullari vlerëson se nuk plotësohen kërkesat e pikave 5 dhe 6 të këtij neni, vendos mosmiratimin e kërkesës. Në rast se titullari vlerëson se nuk ka pengesa për pranimin e kësaj kërkese, miraton kërkesën dhe njofton ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë (*pika 7*) Procedura e verifikimit dhe e shqyrtimit të kërkesës, si dhe të dhënat, që do të bëhen publike në regjistrin elektronik, formati dhe mënyra e përditësimit të tij rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë (*pika 9*).

68. Në kuptim të këtyre parashikimeve, Gjykata vëren se akti normativ i ka lënë në diskrecion titullarit të institucionit të miratojë ose jo kërkesën e një mjeku për të punuar në një institucion shëndetësor jopublik, duke vlerësuar ngarkesën e orëve, mbulimin e shërbimit nga personeli tjetër mjekësor në institucionin shëndetësor publik dhe mundësinë e konfliktit të interesit. Në lidhje me këtë fakt, subjektet e interesuara kanë parashtruar se një parashikim i tillë gjendet edhe në ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike". Gjykata konstaton se neni 8 i këtij ligji ka parashikuar se për kryerjen e veprimtarive të jashtme nëpunësi i administratës publike njofton paraprakisht eprorin direkt dhe njësinë e personelit, por nuk vëren detyrimin për marrjen e miratimit nga ai.

69. Në kuptim të parashikimit të ri ligjor, konstatohet se detyrimi i mjekëve për të bërë kërkesë te titullari për të ushtruar profesionin në një institucion shëndetësor jopublik përbën ndërhyrje/ kufizim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, në kuptim të nenit 11 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata do të vlerësojë, në vijim, nëse ky kufizim ka respektuar kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pra nëse është bërë me ligj, për interes publik dhe nëse është respektuar kriteri i përpjesëtimit midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e ka diktuar atë.

70. Për sa u përket dy kritereve të kufizimit "vetëm me ligj" dhe atij "për interes publik", Gjykata çmon se ato janë respektuar, pasi akti normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2/2024 është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 94/2024. Po kështu, akti normativ synon garantimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor, në kuptim të nenit 55, pika 1, të Kushtetutës, si dhe garantimin e standardeve më të larta të shëndetit publik, sipas nenit 59, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës.

71. Në kushtet kur janë përmbushur dy kriteret e mësipërme të kufizimit, Gjykata vlerëson të analizojë kriterin tjetër, atë të *proporcionalitetit të ndërhyrjes,* në thelb të të cilit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merret në shqyrtim balanca ndërmjet dëmit të shkaktuar individit dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë, masa e mbrojtjes nga arbitrariteti që ofrojnë procedurat ligjore, si dhe mundësia e shtetit për të përdorur mënyra a mjete të tjera për të arritur qëllimin. Shteti, brenda mundësive, duhet të kufizojë ndërhyrjen në minimum, duke kërkuar zgjidhje alternative dhe, përgjithësisht, duke u përpjekur t'i arrijë qëllimet në mënyrë sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 17, datë 23.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

72. Në analizë të përmbajtjes së nenit 8/a, të ligjit nr. 123/2014 konstatohet se ky parashikim ligjor i jep titullarit të institucionit shëndetësor publik një kompetencë vendimmarrëse të gjerë dhe të

pakufizuar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së mjekut për të ushtruar profesionin edhe në një institucion shëndetësor jopublik. Ky mekanizëm vlerësimi, megjithëse formalisht ka për qëllim të sigurojë funksionimin normal të institucioneve publike shëndetësore dhe shmangien e konfliktit të interesit, në praktikë duket se *per se* vendos një kufizim për ushtrimin e së drejtës së mjekut për dypunësim.

73. Gjykata evidenton se dypunësimi i mjekëve nuk është i ndaluar nga ligji, përkundrazi, ai lejohet me plotësimin e kriterit kufizues prej 30% të orëve mujore, i cili garanton ruajtjen e cilësisë së shërbimit publik dhe shmangien e konfliktit të interesit. Në këtë pikë Gjykata thekson se për sa kohë ushtrimi i veprimtarisë në një institucion shëndetësor jopublik nuk pengon kryerjen e detyrave në institucionin publik dhe nuk krijon konflikt interesi, nuk ekziston ndonjë arsye kushtetuese që ta kushtëzojë këtë me dhënien e një lejeje administrative. Vetë balanca midis interesit publik dhe së drejtës individuale ruhet përmes respektimit të detyrimeve të mjekut ndaj institucionit publik dhe rregullave mbi konfliktin e interesit, pa pasur nevojë për një autorizim paraprak nga titullari.

74. Po kështu, Gjykata vlerëson se kriteret mbi të cilat titullari mbështet vlerësimin e tij, si ngarkesa e orëve të punës, mbulimi i shërbimit ose mundësia e konfliktit të interesit, janë të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme dhe nuk shoqërohen me standarde objektive që të mundësojnë një vendimmarrje objektive. Në këtë këndvështrim, mungesa e detyrimit për arsyetimin e vendimit dhe pamundësia e një mjeti efektiv ankimi e bën këtë kompetencë të titullarit diskrecionale dhe nuk ofron garancitë e nevojshme procedurale.

75. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kufizimi që vendos ky nen nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit ndërmjet qëllimit publik të garantimit të standardeve më të larta shëndetësore dhe ushtrimit të lirë të profesionit nga mjekët. Nga njëra anë, ligji vetë njeh mundësinë e dypunësimit të mjekëve si një formë të ligjshme të ushtrimit të profesionit, ndërsa, nga ana tjetër, i jep titullarit një kompetencë vendimmarrëse që praktikisht e bën këtë të drejtë të pamundur për t'u realizuar. Kjo situatë passjell cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi ushtrimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike varet nga vullneti subjektiv i një organi administrativ. Për më tepër, kufizimi i vendosur nga neni 8/a, i ligjit nr. 123/2014, në formën e detyrimit për të marrë leje nga titullari, është i tillë që, në praktikë, mund të çojë në mohimin e plotë të së drejtës për të ushtruar profesionin në sektorin shëndetësor jopublik, duke e bërë kufizimin joproporcional në raport me qëllimin e ndjekur.[12]

76. Për të gjitha argumentet e mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, për sa u përket pikave 1, 3, 5, 7 dhe 9, të nenit 8/a, të ligjit nr. 123/2014, është i bazuar.

C.3 Për cenimin e së drejtës për punë dhe ushtrimin e një profesioni të lidhur me parimin e proporcionalitetit

77. Kërkuesit kanë pretenduar se ashpërsimi drastik i masave disiplinore është bërë pa një analizë në lidhje me qëllimin, por ka qenë rrjedhojë e një ngjarjeje të vetme penale. Sanksioni i heqjes së licencës për ushtrimin e profesionit të mjekut është i ashpër dhe nënkupton mohimin tërësor të së drejtës për të ushtruar profesionin. Sipas tyre, nuk përmbushet as kriteri i përshtatshmërisë, pasi heqja e së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie përbën dënim plotësues në Kodin Penal dhe mund të arrijë qëllimin e kërkuar. Po sipas kërkuesve, mosshuarja e masës disiplinore cenon dinjitetin njerëzor dhe thelbin së drejtës për të ushtruar profesionin e mjekut.

78. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se për një periudhë 18-vjeçare numri i procedimeve ka qenë shumë i ulët, çka tregon se rregulli i deritanishëm nuk ka rezultuar efektiv. Për këtë shkak nevojitet ashpërsimi i masave. Sipas këtyre subjekteve, numri i procedimeve disiplinore ka qenë shumë i ulët ndër vite dhe legjislacioni nuk ka rezultuar efektiv. Po sipas tyre, e drejta e ankimimit të vendimeve të Komisionit të Apelimit është një garanci e shtuar, ndërsa masat disiplinore përmbushin kriterin e proporcionalitetit dhe qëllimi i kërkuar nuk mund të arrihet me masa të tjera. Rregullimi i mënyrës së ushtrimit të profesionit të

[12] Gjyqtarja Marjana Semini vlerësoi se detyrimi i mjekëve për të marrë leje nga titullari për t'u punësuar në një institucion jopublik shëndetësor përmbush kriterin e proporcionalitetit, por cenon parimin e mosdiskriminimit, pasi vendos në pozita jo të barabarta sa i takon marrjes ose jo të lejes për mjekët të cilët janë të punësuar në strukturat me autonomi financiare në krahasim me kolegët e tjerë të punësuar në të njëjtën strukturë.

mjekut është i domosdoshëm me qëllim eficiencën në ofrimin e shërbimit.

79. E drejta për punë, sipas nenit 49, pika 1, të Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit, në kuptimin që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 9, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

80. Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën së drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë. Në këtë mënyrë e trajton të drejtën për punë edhe doktrina kushtetuese, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese (*shih vendimin nr. 20, datë 11.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

81. E drejta për ushtrimin e një profesioni mund të kufizohet nga rregullime të arsyeshme që mund t'u atribuohen konsideratave të së mirës së përgjithshme. Nëse ligjvënësi e kushtëzon të drejtën për të nisur një aktivitet profesional me përmbushjen e disa kritereve të caktuara, duke cenuar kështu të drejtën për të zgjedhur një profesion, në këtë rast rregullimet për të mirën e përgjithshme janë të legjitimuara. Por këto kufizime duhen bërë vetëm kur veprime të tilla janë absolutisht të nevojshme për të mbrojtur në veçanti interesa të rëndësishëm të komunitetit dhe duhet që në të gjitha këto raste masa kufizuese e përzgjedhur të përmbajë cenimin më të vogël të mundshëm (*shih vendimet nr. 17, datë 23.3.2023; nr. 9, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

82. Nisur nga analiza e mësipërme (*shih paragrafin 44 të vendimit*), Gjykata çmon ta analizojë këtë pretendim në dy drejtime: në aspekt të paqartësisë së normës dhe të proporcionalitetit të ndërhyrjes.

83. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kur kontrollohen aktet e pushtetit publik sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen parimet që lidhen me cilësinë e ligjit, parashikueshmërinë, sigurinë juridike dhe barazinë përpara ligjit, pasi janë pikërisht ato që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit (*shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 30, datë 2.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, ligji duhet jo vetëm të jetë i aksesueshëm për të interesuarin dhe i parashikueshëm për efektet e tij, por edhe mjaftueshmërisht i qartë, me qëllim që t'u japë individëve një tregues të përshtatshëm për rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuara të ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese të tyre (*shih vendimet nr. 32, datë 30.5.2023; nr. 30, datë 2.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzistenca e paqartësisë, e pasaktësisë, e kontradiksionit logjik ose e pazbatueshmërisë së normave ligjore mbartin drejtpërsëdrejti rrezikun e mosrespektimit të parimit të shtetit të së drejtës, pasi një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit për t`i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe me pasoja, nuk është në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike (*shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 36, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

84. Gjykata vëren se me nenin 10 të aktit normativ është ndryshuar neni 17, i ligjit nr. 123/2014, sipas të cilit janë riformuluar masat disiplinore të zbatueshme ndaj anëtarëve të Urdhrit të Mjekëve. Kështu, sipas pikës 1, shkronja "d", të nenit 17, Komisioni Disiplinor heton e gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe të seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit të Mjekëve, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit të Etikës dhe të Deontologjisë Mjekësore ose ka bërë gabime teknike, Urdhri i Mjekëve, ndër të tjera, jep masën disiplinore "Heqja e licencës për ushtrimin e profesionit të mjekut". Ndërsa sipas pikës 3 të këtij neni kjo masë disiplinore nuk shuhet.

85. Në analizë të këtij parashikimi, Gjykata çmon se mënyra e formulimit të kësaj dispozite mbart paqartësi për kriteret dhe shkallën e shkeljeve që mund të çojnë në aplikimin e masës më të rëndë

disiplinore, atë të heqjes së licencës. Ligjvënësi nuk ka përcaktuar qartë nëse kjo masë lidhet vetëm me raste të rënda të shkeljeve etike dhe deontologjike, ose mund të aplikohet edhe për gabime teknike të karakterit profesional, të cilat mund të kenë natyrë dhe peshë të ndryshme. Në vlerësimin e Gjykatës, një mungesë e tillë krijon pasiguri juridike si për subjektet që i nënshtrohen këtij parashikimi, ashtu edhe për vetë Urdhrin e Mjekëve që zbaton dispozitën, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme dhe për rrezikun e vendimmarrjes arbitrare. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se dispozita në fjalë nuk përmbush standardin e qartësisë dhe të parashikueshmërisë së ligjit, i cili është një element thelbësor i parimit të shtetit të së drejtës dhe i sigurisë juridike, të garantuara nga neni 4 i Kushtetutës.

86. Gjithashtu, Gjykata thekson se çdo ndërhyrje që prek ushtrimin e së drejtës për të ushtruar profesionin duhet të bazohet në norma të qarta, të kuptueshme dhe të parashikueshme, në mënyrë që individi (mjeku në rastin konkret) të mund të dijë paraprakisht pasojat disiplinore të veprimeve ose mosveprimeve të tij. Mungesa e një përcaktimi të tillë objektiv bën që masa disiplinore e heqjes së licencës të zbatohet në mënyrë disproporcionale me qëllimin e ndëshkimit disiplinor.

87. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se dispozita e ndryshuar e nenit 17, të ligjit nr. 123/2014, në pjesën që parashikon aplikimin e masës disiplinore "Heqja e licencës për ushtrimin e profesionit të mjekut", nuk plotëson standardin kushtetues të qartësisë dhe të parashikueshmërisë.

88. Përveç sa më sipër, Gjykata konstaton se masa disiplinore e heqjes së licencës përbën në thelb ndërhyrje në të drejtën për punë dhe për të ushtruar profesionin, të garantuar në nenin 49 të Kushtetutës, e cila do të analizohet në vijim në përputhje me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pra nëse është bërë me ligj, për interes publik dhe nëse është respektuar kriteri i përpjesëtimit midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e ka diktuar atë. Fillimisht Gjykata evidenton se përpara ndryshimeve me aktin normativ, heqja e licencës nuk ishte e parashikuar si masë disiplinore, por ky nen parashikonte përjashtimin nga Urdhri i Mjekëve për një periudhë deri në 3 vjet.

89. Për sa u përket dy kritereve të para, të "kufizimit vetëm me ligj" dhe "ndërhyrjes për interes publik", Gjykata i konsideron ato të përmbushura, duke iu referuar analizës së mësipërme për pretendimin e cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike (*shih paragrafin 70 të vendimit*). Në lidhje me kriterin e proporcionalitetit, Gjykata bazuar edhe në pretendimet e kërkueseve, çmon ta analizojë atë në drejtim të ashpërsisë së masës.

90. Në këtë kuptim, Gjykata evidenton fillimisht se heqja e së drejtës së ushtrimit të profesionit është një nga masat më të ashpra të parashikuara nga akti normativ, e cila në thelb penalizon mjekun duke e ndaluar të ushtrojë profesionin e tij. Nga leximi literal i dispozitës duket se kjo masë disiplinore, e cila jepet për shkaqe që lidhen me shkelje të rregullave të Kodit të Etikës e për një afat të pacaktuar, ndonëse ka karakter administrativ, është më e ashpër edhe se vetë dënimi plotësues në procesin penal, në kuptim të nenit 39 të Kodit Penal. Sipas këtij neni, heqja e së drejtës së ushtrimit të një veprimtarie ose të një profesioni jepet për një kohë të caktuar dhe është rrjedhojë e çdo dënimi për vepra penale që kryhen, duke i shpërdoruar ato, ose kur vlerësohet se ushtrimi i mëtejshëm i veprimtarisë ose profesionit bie ndesh me marrëdhënien juridike që synon të mbrojë vepra penale konkrete. Ndonëse heqja e së drejtës për ushtrimin e profesionit sipas ndryshimeve të reja ligjore ndjek një kronologji të caktuar në nivelin e ashpërsimit të masës, e vendosur në këtë mënyrë duket të jetë arbitrare dhe përbën një kufizim më të ashpër sesa është i nevojshëm për arritjen e qëllimit të synuar, që është mbrojtja e jetës dhe shëndeti i individëve, për rrjedhojë e cenon këtë drejtë në atë masë sa, në thelb, e asgjëson atë.

91. Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata sjell në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila, ndonëse e ka trajtuar ndalimin e përhershëm të ushtrimit të profesionit të mjekut në kuadër të nenit 7 të KEDNJ-së, pra të mosdënimit pa ligj, ka argumentuar se një masë kaq e ashpër, në thelb, përbën një dënim penal (*shih Gouarré Patte kundër Andorrës, datë 12.1.2016, § 35*).

92. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se parashikimi në aktin normativ i masës disiplinore të heqjes së licencës në mënyrë të përhershme dhe pa përcaktuar kritere të qarta, për të cilat ajo mund të jepet, shkon përtej karakterit të dënimit penal dhe për këtë arsye kjo masë cenon në thelb të drejtën për punë dhe ushtrimin e një profesioni. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve në këtë drejtim është i bazuar, prandaj Gjykata vlerëson se shkronja "d", e pikës 1, të nenit

17 dhe fjalia e fundit e pikës 3 të po këtij neni, ndryshuar me nenin 10 të aktit normativ nr. 2/2024 duhet të shfuqizohen.

Ç. Për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës

93. Gjykata, bazuar në analizën e mësipërme (*shih paragrafët 30 dhe 42 të vendimit*), në kushtet kur konstatoi cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, së drejtës për punë dhe ushtrimin e një profesioni, çmon të vijojë me analizën në themel të pretendimit të kërkuesve për cenimin e nenit 101 të Kushtetutës, pra nëse akti normativ ka dalë në kushtet e nevojës dhe të urgjencës.

94. Kërkuesit kanë pretenduar se Këshilli i Ministrave nuk ka arritur të provojë nevojën që ka ekzistuar për miratimin e aktit normativ dhe faktin nëse fenomeni i lëvizjes së mjekëve gjatë orarit zyrtar në klinika private ka ekzistuar prej kohësh, duke mos u bazuar në dokumente, raporte ose statistika. Po sipas tyre, Këshilli i Ministrave nuk ka argumentuar nëse fenomeni mund të zgjidhej me ndërhyrje normative ose ishte problematikë e moszbatimit të rregullave ligjore aktuale dhe mosveprimit të autoriteteve për formimin e mekanizmave kontrollues dhe monitorues për respektimin e orarit të punës. Gjithashtu, kërkuesit kanë parashtruar se një ngjarje e vetme penale nuk mund të konsiderohet si "situatë jo e zakonshme", e cila kërkon nevojën urgjente për ndërhyrje nëpërmjet një akti normativ. Sipas kërkuesve, nuk përmbushet as kriteri i urgjencës, pasi ngjarja që ka shërbyer për fillimin e procesit është ndjekur penalisht nga prokuroria, ndaj Këshilli i Ministrave nuk pengohej të ndiqte procedurën e zakonshme ligjvënëse. Çështjet e disiplinës në punë dhe respektimi i orarit nuk bëjnë urgjencë që kërkon miratimin e një akti normativ.

95. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi plotësohen kriteret e nevojës dhe të urgjencës. Sipas tyre, nevoja për miratimin e aktit normativ konsiston në mungesën e rregullimit ligjor të ushtrimit të profesionit të mjekut në mënyrë të njëkohshme në sistemin shëndetësor publik dhe jopublik, faktit se legjislacioni për etikën nuk ka rezultuar efektiv dhe për garantimin e kujdesit shëndetësor. Për sa i përket kriterit të urgjencës, subjektet e interesuara kanë parashtruar se ai u evidentua pas hetimit penal të datës 25.6.2024, i pasuar nga hetimi administrativ, ndërsa analiza e raporteve për gjendjen e sistemit shëndetësor kërkoi një periudhë kohore deri në paraqitjen e propozimit për aktin normativ. Po sipas tyre, ndjekja e procesit legjislativ do të kërkonte 3-9 muaj, ndërsa miratimi me procedurë të përshpejtuar do të pengohej nga mbyllja e sesionit parlamentar, ndaj ndërhyrja urgjente është e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të shërbimit shëndetësor publik dhe abuzimin në ofrimin e këtij shërbimi.

96. Neni 101 i Kushtetutës parashikon se Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

97. E drejta e pushtetit ekzekutiv për të ushtruar autoritet me anë të akteve normative me fuqinë e ligjit duhet të justifikohet në çdo rast me praninë e rrethanave të veçanta që e bëjnë të nevojshëm miratimin e rregullimit urgjent *(shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese)*. Nevoja dhe urgjenca janë kushte me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Kuptimi i tyre është autonom, i lidhur me tërësinë e përmbajtjes së dispozitës dhe me parimet bazë që përshkojnë Kushtetutën *(shih vendimet nr. 1, datë 6.2.2013; nr. 24, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese)*. Duke qenë kushte paraprake, nevoja dhe urgjenca duhet të jenë vërtetuar se ekzistojnë përpara momentit të marrjes të iniciativës nga qeveria për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit *(shih vendimin nr. 24, datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese)*.

98. Lidhur me këtë pretendim, në përfundim të diskutimeve, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe pretendimi u konsiderua i rrëzuar.

99. Kështu, sipas njërit qëndrim, akti normativ synon garantimin e jetës dhe të shëndetit të shtetasve, rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor dhe sigurimin e aksesit efektiv të tyre në shërbimin shëndetësor. Punësimi i mjekëve njëkohësisht në sistemin shëndetësor publik dhe jopublik ka qenë një çështje e parregulluar në mënyrë të plotë nga legjislacioni në fuqi dhe bazuar në relacionin e

Këshillit të Ministrave parashikimet ligjore të deritanishme janë treguar joefektive në drejtim të etikës. Në këto kushte, miratimi i aktit normativ paraqitet si masë e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit publik dhe për funksionimin e rregullt të shërbimit shëndetësor. Edhe për sa i përket kushtit të urgjencës, procedimi penal i muajit qershor 2024 solli domosdoshmërinë e ndryshimeve ligjore, ndërsa procesi legjislativ kërkon kohë që zgjat për një periudhë disa mujore, sikurse janë hartimi i projektligjit, faza e konsultimit, paraqitja në komisionet përkatëse dhe diskutimi i tij, miratimi në seancë plenare në varësi të kalendarit të punimeve të Kuvendit, publikimi në Fletoren Zyrtare dhe hyrja në fuqi. Ndërkohë parandalimi i situatave të krijuara në ofrimin joadekuat të shërbimit shëndetësor publik ka kërkuar ndërhyrjen e menjëhershme nëpërmjet aktit normativ.[13]

100. Sipas qëndrimit tjetër, në parim, akti normativ përbën një masë të jashtëzakonshme, me të cilin Këshilli i Ministrave ushtron përjashtimisht kompetencë legjislative që, si rregull, i përket një pushteti tjetër, ndaj ekzistenca e nevojës dhe e urgjencës ka rëndësi thelbësore. Në rastin konkret, akti normativ nuk përmbush kushtet e nevojës, pasi ndonëse Këshilli i Ministrave ka argumentuar se masa synon garantimin e jetës dhe të shëndetit të shtetasve, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor, jo domosdoshmërish situata të papritura ose të jashtëzakonshme kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme me akt normativ. Çështja e punësimit të mjekëve njëkohësisht në shërbimin shëndetësor publik dhe jopublik ka qenë e njohur prej kohësh dhe mungesa e një rregullimi të plotë ligjor nuk përbën *apriori* nevojën për ndryshime ligjore. Lidhur me kushtin e urgjencës, ekzistenca e një procedimi penal e nisur për një numër mjekësh në muajin qershor 2024 qartësisht nuk provon një rrezik të menjëhershëm për funksionimin e shërbimit shëndetësor, i cili të kërkonte detyrimisht shmangien e procesit të zakonshëm legjislativ dhe nxjerrjen e aktit normativ në muajin gusht 2024. Ky proces, pavarësisht kohëzgjatjes, është rruga e zakonshme dhe kushtetuese për ndryshimet e politikave publike dhe shqetësimet e evidentuara nuk justifikojnë ndërhyrjen përmes instrumentit të jashtëzakonshëm të aktit normativ.[14]

101. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesve janë të bazuara pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "h", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e pikave 1, 3, 5, 7 dhe 9, të nenit 8/a, të ligjit nr. 123/2014, "Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shtuar me nenin 5, të aktit normativ nr. 2, datë 1.8.2024, si dhe të shkronjës "d", të pikës 1, të nenit 17 dhe të fjalisë së fundit të pikës 3 të po këtij neni, ndryshuar me nenin 10, të aktit normativ nr. 2, datë 1.8.2024, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.10.2025.

Shpallur më 24.12.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Marjana Semini

Anëtar pjesërisht kundër: Marsida Xhaferllari

[13] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Marjana Semini.

[14] Votoi sipas këtij qëndrimi gjyqtarja Marsida Xhaferllari

VENDIM
Nr. 74, datë 20.11.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj, kryetare;
Marsida Xhaferllari, anëtare;
Fiona Papajorgji, anëtare;
Sonila Bejtja, anëtare;
Sandër Beci, anëtar;
Genti Ibrahimi, anëtar;
Marjana Semini, anëtare;
Ilir Toska, anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 20.11.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 6 (B) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Bibë Kaza, përfaqësuar nga avokat Ndue Marku, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3570, datë 19.9.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 42, 44, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 45, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Bibë Kaza (*kërkuesi)*, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH)*, Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka shërbyer si oficer aktiv në Forcat e Armatosura nga data 18.5.1981 deri në datën 1.8.2004, kur ka dalë në rezervë me gradën "Kolonel" dhe me vjetërsi shërbimi si ushtarak aktiv për 23 vjet e 2 muaj.

2. Pas përfundimit të trajtimit me pagesë kalimtare, në datën 1.8.2006, kërkuesi është trajtuar në vijim me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi *(pensioni i parakohshëm)*. Me vendimin nr. 4168, datë 25.1.2008 *(vendimi nr. 4168/2008)* DRSSH-ja, Tiranë i ka caktuar atij pensionin e parakohshëm, me të drejtë pagese nga data 1.8.2006, deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie. Pensioni është përllogaritur në bazë të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8087/1996),* duke u përcaktuar në masën 16.007 lekë në muaj, sa pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë vendi. Kërkuesi ka paraqitur disa kërkesa për rillogaritjen e pensionit të parakohshëm pranë DRSSH-së, Tiranë, por nuk ka marrë përgjigje.

3. Më pas, ai i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e DRSSH-së, Tiranë: i. të rillogarisë dhe të paguajë masën e pensionit të parakohshëm në përputhje me nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (*ligji nr. 9210/2004*), për periudhën 1.8.2006–30.6.2009, duke përfshirë indeksimin vjetor të pensionit; ii. të paguajë diferencat midis masës së pensionit të rillogaritur dhe atij të paguar për të njëjtën periudhë.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4655 (80-2015-3038), datë 25.9.2015, ka vendosur pranimin e padisë së kërkuesit, sipas objektit të saj. Ajo ka arsyetuar se, edhe pse në çastin e lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm ishte në fuqi ligji nr. 9418, datë 20.5.2005, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 9418/2005*), në mungesë të akteve nënligjore për zbatimin e tij, caktimi dhe llogaritja e

masës së pensionit me të drejtë janë bazuar në ligjin nr. 8087/1996. Megjithatë, organi i sigurimeve shoqërore ka gabuar kur, për periudhën objekt gjykimi 1.8.2006–30.6.2009 ka kufizuar masën e pensionit të parakohshëm sipas nenit 11, shkronja "b", të këtij ligji, në kushtet kur, nga data 14.5.2004, shprehja: "por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi", në shkronjën "b" të këtij neni ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9210/2004 (neni 49). Referuar ekspertimit gjyqësor, diferenca e papaguar e pensionit të parakohshëm për periudhën 1.8.2006–30.6.2009, është 3.111.328 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, subjekti i interesuar, DRSSH-ja, Tiranë.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1690 (1684), datë 20.4.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuesit. Ajo ka arsyetuar se, ndonëse në datën 1.8.2006, të lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm në fuqi ishte ligji nr. 9418/2005, bazuar në vendimin unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë *(vendimi unifikues nr. 3/2016),* ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të tij është ligji nr. 8087/1996, përfshirë edhe kufizimin e masës së pensionit sipas nenit 11, shkronja "b", të tij sa masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Për rrjedhojë, pensioni i parakohshëm për kërkuesin është caktuar dhe paguar në përputhje me ligjin. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3570, datë 19.9.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012)*. Sipas këtij kolegji, shkaqeve në rekurs u ishte dhënë përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka analizuar dispozitat ligjore të zbatueshme, konkretisht të ligjeve nr. 8087/1996 dhe nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*), duke e zgjidhur çështjen në meritë në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016.

7. Në datën 13.2.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pas plotësimit sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, u regjistrua në datën 24.2.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 23.4.2025, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. ***Kërkuesi*****,** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* për shkak se:

8.1 Gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të parashtruara përpara shqyrtimit të çështjes, të cilat as nuk i ka pasqyruar në vendimin e saj. Po kështu, ajo ka dalë përtej kufijve të ankimit të palës së paditur, duke u investuar kryesisht për çështje që nuk janë ngritur në ankim. Arsyetimi i vendimit të saj nuk përputhet me faktet dhe me situatën juridike të çështjes, duke e bërë vendimin të paarsyetuar dhe jologjik. Në planin material, gjykata e apelit nuk ka zbatuar ligjin sipas përmbajtjes së tij në çastin e lindjes të së drejtës. Ajo i është referuar vendimit unifikues nr. 3/2016, i cili ka përcaktuar si të zbatueshëm ligjin nr. 8087/1996 bashkë me kufizimin e masës së pensionit në nenin 11 të tij. Megjithatë, një zbatim i tillë i ligjit bie haptazi ndesh me parimin e ligjshmërisë, pasi mungesa e akteve nënligjore nuk e bën të pazbatueshëm nenin 49 të ligjit nr. 9210/2004, i cili zbatohet drejtpërdrejt. Për pasojë, vijon kërkuesi, është sjellë në fuqi një normë e shfuqizuar 12 vjet më parë, duke marrë kompetencat e pushtetit legjislativ dhe duke mos zbatuar ligjin në mënyrë uniforme, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Kushtetutës, por edhe të parimit të sigurisë juridike, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës.

8.2 Edhe pse në rekursin e tij janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, por edhe për

shkelje të rënda të ligjit material dhe atij procedural nga gjykata e apelit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mbajtur qëndrim formal, skematik dhe të thjeshtëzuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vëren se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae* në lidhje me vendimin e kundërshtuar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhënë në procesin gjyqësor të vënë në lëvizje nga ai, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i takon vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjithashtu i kundërshtuar në përmbajtjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata vëren se, sipas jurisprudencës saj, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 24, datë 23.4.2025; nr. 77, datë 5.11.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në rastin konkret, kërkuesi nuk ka qenë palë në procesin ku është dhënë vendimi unifikues i kundërshtuar, ndaj, në aspektin procedural, ai nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e tij. Megjithatë, në aspektin substancial, Gjykata çmon të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues, për aq sa referuar atij gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në çështjen konkrete.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

13. Në drejtim të legjitimimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 19.9.2024 dhe sipas korrespondencës së kërkuesit me atë gjykatë, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, ai vendim është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 14.10.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 13.2.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae,* kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, por edhe të parimit të sigurisë juridike, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues. Nisur nga thelbi i pretendimeve, që lidhen me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, ato do të trajtohen në vijim në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

15. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara përpara shqyrtimit të çështjes, të cilat as nuk i ka pasqyruar në vendimin e

saj. Po kështu, ajo ka dalë përtej kufijve të ankimit të palës së paditur, duke u investuar kryesisht për çështje që nuk janë ngritur në ankim. Arsyetimi i vendimit të saj, sipas kërkuesit, nuk përputhet me faktet dhe situatën juridike të çështjes, duke e bërë vendimin të paarsyetuar dhe jologjik. Në planin material, gjykata e apelit nuk ka zbatuar ligjin sipas përmbajtjes së tij në çastin e lindjes të së drejtës. Ajo i është referuar vendimit unifikues nr. 3/2016, i cili ka përcaktuar si të zbatueshëm ligjin nr. 8087/1996, bashkë me kufizimin e masës së pensionit në nenin 11 të tij. Megjithatë, një zbatim i tillë i ligjit bie haptazi ndesh me parimin e ligjshmërisë, pasi mungesa e akteve nënligjore nuk e bën të pazbatueshëm nenin 49, të ligjit nr. 9210/2004, i cili zbatohet drejtpërdrejt. Për pasojë, vijon kërkuesi, është sjellë në fuqi një normë e shfuqizuar 12 vjet më parë, duke marrë kompetencat e pushtetit legjislativ dhe duke mos zbatuar ligjin në mënyrë uniforme, në shkelje të neneve 7 dhe 17 të Kushtetutës, por edhe të parimit të sigurisë juridike, të garantuar nga neni 4 i Kushtetutës. Edhe Gjykata e Lartë, shprehet kërkuesi, ndonëse në rekursin e tij janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, por edhe për shkelje të rënda të ligjit material dhe procedural nga gjykata e apelit, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mbajtur qëndrim formal, skematik dhe të thjeshtëzuar.

16. Duke sjellë në vëmendje se neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon edhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Gjykata çmon të ritheksojë se roli i saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë. Ajo nuk vepron si "gjykatë e shkallës së katërt", ndaj ndërhyrja e saj justifikohet vetëm kur gjetjet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, pra kur gabimi ligjor ose faktik nga ato është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 24, datë 23.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, Gjykata çmon të ritheksojë se ai përfshin, mes të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitimë të tyre, atëherë do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, parimi i sigurisë juridike nuk shfaqet asnjëherë si i tillë në vetvete, por shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të fituara, vazhdimësinë ligjore, qartësinë dhe përcaktueshmërinë në normimin e marrëdhënieve juridike dhe respektimin e pritshmërive legjitime (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 10, datë 29.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po në drejtim të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se ai përfshin edhe ndalimin e fuqisë prapavepruese të normave juridike, i cili nënkupton se është e pamundur të gjykohen sipas normave ligjore në fuqi, sjellje njerëzore, fakte ligjore ose marrëdhënie ligjore që kanë ndodhur përpara se këto norma të hynin në fuqi. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre në kohën e ardhme dhe fuqia prapavepruese zbatohet në raste përjashtimore, sepse, në të kundërt, mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 78, datë 6.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese).* Fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm ose në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Nocioni i fuqisë prapavepruese është i pranishëm në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri për sa u përket transaksioneve të shkuara (*shih*

vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 1, datë 31.1.2003, të Gjykatës Kushtetuese).

19. Gjykata rithekson gjithashtu se pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet në konsideratë të natyrës së punës së ushtarakëve, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Prandaj ligjvënësi parashikoi krijimin e një sistemi përfitimesh suplementare që të garantohej ruajtja e një niveli të krahasueshëm jetese dhe ekonomik për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilëve u ndërpriteshin marrëdhëniet e punës. Në këtë këndvështrim, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi mbrohet nga parimi i sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 33, datë 24.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Për legjislacionin që ka rregulluar ndër vite të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët e Forcave të Armatosura, kontrollin e tyre kushtetues dhe për sa u përket përfundimeve njësuese të vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për zbatimin në kohë dhe efektin prapaveprues të legjislacionit për pensionin e parakohshëm, si dhe skemën e zbatueshme për llogaritjen e masës së këtij pensioni, Gjykata e ka bërë tashmë në disa raste (*shih vendimet nr. 34, datë 27.5.2025; nr. 25, datë 23.4.2025; nr. 24, datë 23.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese),* ndaj çmon të mos ndalet në evidentimin e tij në hollësi edhe në këtë vendim.

21. Nisur nga thelbi i parashtrimeve të kërkuesit, si dhe bazuar në standardet kushtetuese të sipërcituara, Gjykata, në vijim, do të analizojë nëse interpretimi që Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë ligjit material të zbatueshëm në mosmarrëveshjen objekt gjykimi i ka cenuar kërkuesit të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të përfituar për shkak të parashikimeve ligjore, pra nëse në interpretimin që ato gjykata i kanë bërë ligjit të zbatueshëm në rastin e kërkuesit ka ose jo elemente të arbitraritetit.

22. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 1.8.2006. Trajtimi i tij me këtë pension është bazuar në ligjin nr. 8087/1996, të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe është caktuar në masën 16.007 lekë në muaj, sipas aktit administrativ, vendimit nr. 4168/2008 të DRSSH-së, Tiranë. Ai ka kërkuar nga kjo e fundit, në disa raste, rillogaritjen e masës së pensionit, por nuk ka marrë përgjigje. Pas kësaj, kërkuesi i është drejtuar gjykatës administrative, duke kërkuar detyrimin e organit administrativ t'i rillogarisë dhe t'i paguajë atij pensionin e parakohshëm për periudhën 1.8.2006–30.6.2009, në përputhje me masën e përcaktuar në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 9210/2004, si dhe t'i paguajë diferencat midis masës së pensionit të rillogaritur dhe atij të paguar, për të njëjtën periudhë.

23. Padia e kërkuesit është pranuar nga gjykata administrative e shkallës së parë. Ajo ka arsyetuar se, edhe pse në çastin e lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm ishte në fuqi ligji nr. 9418/2005, në mungesë të akteve nënligjore për zbatimin e tij, caktimi dhe llogaritja e masës së pensionit të parakohshëm me të drejtë është bazuar në ligjin nr. 8087/1996. Megjithatë, sipas saj, organi i sigurimeve shoqërore ka gabuar kur për periudhën objekt gjykimi 1.8.2006–30.6.2009 ka kufizuar masën e pensionit të parakohshëm sipas nenit 11, shkronja "b", të këtij ligji, në kushtet kur nga data 14.5.2004, shprehja: "por jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi", në shkronjën "b" të këtij neni ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9210/2004 (neni 49). Për pasojë, sipas asaj gjykate, llogaritja dhe pagimi i pensionit të parakohshëm për kërkuesin janë në kundërshtim me ligjin dhe referuar ekspertimit gjyqësor, diferenca e papaguar për periudhën 1.8.2006–30.6.2009 është 3.111.328 lekë.

24. Çështja është shqyrtuar në vijim nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkuesit. Edhe sipas gjykatës së apelit, ndonëse në datën 1.8.2006 të lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm në fuqi ishte ligji nr. 9418/2005, bazuar në vendimin unifikues nr. 3/2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ligji i zbatueshëm për llogaritjen e masës së pensionit të tij ishte ligji nr. 8087/1996, përfshirë edhe kufizimin e masës së pensionit, sipas nenit 11, shkronja "b", të tij, sa masa e pensionit të pleqërisë në shkallë vendi. Për rrjedhojë, sipas gjykatës së apelit, pensioni i parakohshëm për kërkuesin është caktuar dhe paguar në përputhje me ligjin.

25. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012 dhe se pretendimeve në rekurs u ishte dhënë përgjigje shteruese nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka analizuar dispozitat ligjore të zbatueshme dhe e ka zgjidhur çështjen në meritë në bazë të vendimit unifikues nr. 3/2016. Po sipas tij, nuk ka zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural nga Gjykata Administrative e Apelit dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.

26. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe duke pasur në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se kërkuesit i ka lindur e drejta për pension të parakohshëm në datën 1.8.2006. Në atë kohë kjo e drejtë rregullohej nga nenet 13 dhe 14 të ligjit nr. 9418/2005 të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, të cilat përcaktonin kushtet dhe kriteret për përfitimin e pensionit të parakohshëm dhe masën e tij, konkretisht 50% të pagës referuese dhe për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm (15 vjet për meshkujt), masa e pensionit shtohej me 2% të pagës referuese, me kufizimin se për ushtarakët me gradën "Kolonel" masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të ishte më e madhe se 5-fishi i pensionit bazë. Ndërkohë, për shkak të shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004, të tavanit të masës së pensionit maksimal të pleqërisë, sipas shkronjës "b", të nenit 11, të ligjit nr. 8087/1996, si dhe parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 9418/2005, sipas të cilit, me hyrjen e tij në fuqi, ligji nr. 8087/1996 dhe aktet e dala në zbatim të tij nuk do të zbatoheshin për ushtarakët e Forcave të Armatosura që përfitonin sipas këtij ligji, kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme se do të përfitonte nga këto dispozita, pra se ndaj atij nuk do të zbatohej tavan/kufizim në masën e pensionit të parakohshëm (referuar ligjit nr. 9210/2004) ose që ky kufizim do të ishte deri në 5-fishin e pensionit bazë (referuar ligjit nr. 9418/2005, të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006).

27. Megjithatë, Gjykata konstaton se pavarësisht ligjit në fuqi në çastin e lindjes për kërkuesin të së drejtës për pension të parakohshëm, konkretisht të ligjit nr. 9418/2005 të ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, Gjykata Administrative e Apelit ka arritur në përfundimin se ky ligj nuk zbatohej, por zbatohej ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, megjithëse neni 33 i ligjit të parë parashikonte shprehimisht se ky i dyti nuk do të zbatohej për ushtarakët e Forcave të Armatosura, që përfitonin sipas këtij ligji (ligjit të parë). Për këtë, ajo i është referuar vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin, duke iu referuar nenit 29, pika 1, të ligjit nr. 10142/2009, është arritur në përfundimin se për periudhën nga data 1.1.1999 dhe deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10142/2009, pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi përllogaritej sipas ligjit nr. 8087/1996 (të ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999), përfshirë edhe përfituesit që u ka lindur e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në kohën kur në fuqi ka qenë ligji nr. 9418/2005 (i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006), i cili nuk zbatohej. Sipas Kolegjeve të Bashkuara, zbatimi me fuqi prapavepruese i nenit 29, të ligjit nr. 10142/2009 është në përputhje me Kushtetutën, sikurse edhe Gjykata ka vlerësuar në vendimet nr. 33/2010 dhe nr. 2/2013. Megjithatë, Gjykata vëren se neni 29, i ligjit nr. 10142/2009 rregullon rillogaritjen e të drejtave të njohura dhe pika 1 e tij përcakton zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8087/1996, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji (nr. 10142/2009), duke mos u shprehur për ndonjë efekt prapaveprues të ligjit në fjalë dhe as për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 ose rregullimin ndryshe të pasojave të ardhura nga zbatimi i tij. Po kështu, edhe në vendimet e referuara të Gjykatës nuk ka ndonjë vlerësim për (pa)zbatueshmërinë e ligjit nr. 9418/2005 për periudhën që ai ka qenë në fuqi dhe as për zbatimin në mënyrë përjashtimore me efekt prapaveprues të ligjit nr. 10142/2009, pra me qëllim rregullimin e ndonjë prej atyre situatave, të cilat, në aspektin kushtetues, në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, do të lejonin, përjashtimisht, zbatimin me efekt prapaveprues të këtij ligji ndaj situatave ose marrëdhënieve të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi.

28. Përtej kësaj, Gjykata konstaton se ndonëse tavani i masës së pensionit maksimal të pleqërisë ishte shfuqizuar me ligjin nr. 9210/2004, Gjykata Administrative e Apelit e kufizoi pensionin e parakohshëm të kërkuesit për periudhën 1.8.2006–30.6.2009 në masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi, duke u mbështetur në nenin 11, të ligjit nr. 8087/1996, të ndryshuar me

ligjin nr. 8521/1999 dhe duke vlerësuar se ligji nr. 9210/2004 nuk mund të zbatohej për mungesë të daljes së akteve nënligjore për zbatimin e tij.

29. Duke arsyetuar si më lart, Gjykata Administrative e Apelit nuk duket se ka mbajtur parasysh rregullimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit gjykata e shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ, duke mos marrë në konsideratë për llogaritjen e masës së pensionit, kushtet dhe kriteret, sipas parashikimeve ligjore në fuqi për atë periudhë. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, vendimi i gjykatës së apelit nuk duket se përmbush kërkesat e gjykimit të drejtë në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

30. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar përmbajtjen e ligjit nr. 9210/2004 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 10142/2009, si dhe mënyrën e interpretimit të tyre nga gjykata e apelit. Ajo nuk shprehet as për arsyet se përse ligji nr. 9418/2005, i ndryshuar me ligjin nr. 9481/2006, i identifikuar nga të dyja gjykatat më të ulëta si ligji në fuqi në çastin e lindjes të së drejtës për kërkuesin, është i pazbatueshëm për periudhën 1.8.2006–30.6.2009. Po kështu, ajo nuk shpjegon se përse në rastin konkret kishte vend për zbatimin e vendimit unifikues nr. 3/2016 për këtë periudhë dhe përse ligji i identifikuar si i zbatueshëm edhe nga gjykata e apelit (ligji nr. 8087/1996) vijon të përmbajë kufizim të masës së pensionit të parakohshëm (jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi), në një kohë kur ky kufizim është shfuqizuar, sikurse ka pranuar gjykata e shkallës së parë. Për pasojë, nuk duket se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në rekurs për ligjin e zbatueshëm, sikundër edhe për sa i përket zbatimit të kritereve ligjore të parashikuara nga ligji nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999, për periudhën 1.8.2006–30.6.2009, si pasojë e shfuqizimit me ligjin nr. 9210/2004 të masës së tavanit të pensionit të parakohshëm.

31. Në rrethanat si më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk mund të mjaftohej me një arsyetim të kufizuar, por duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve në rekurs të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të masës së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke mbajtur në veçanti qëndrim për sa i përket kufizimit të masës së pensionit të kërkuesit për periudhën 1.8.2006–30.6.2009. Prandaj, vendimi i saj cenon të drejtën e kërkuesit për gjykim të drejtë në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimin e sigurisë juridike për të drejtën e pensionit të parakohshëm të fituar prej tij nga ligji.

32. Për këto arsye, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së pensionit të parakohshëm për shkak të interpretimit të paarsyeshëm të ligjit është i bazuar. Megjithatë, duke pasur parasysh rolin subsidiar të saj në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Gjykata vlerëson se i takon Gjykatës së Lartë të kontrollojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material, prandaj vendimi i saj duhet të shfuqizohet.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e bazuar, ndaj ajo pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3570, datë 19.9.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.11.2025.
Shpallur më 24.12.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Marjana Semini

VENDIM
Nr. 75, datë 20.11.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 20.11.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 32 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Afroviti Xufa, përfaqësuar nga avokat Thomas Dhimolea, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit nr. 77205-00133-00-2024, datë 16.1.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë si i papajtueshëm me nenin 6 të KEDNJ-së.

Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.

Shfuqizimin e fjalës "/ose", në nenin 399/3, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile dhe, fjalinë "dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen vendimi i gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni" në nenin 399/4, pika 2 të Kodit të Procedurës Civile, si të papajtueshëm me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Pagimin e shpenzimeve gjyqësore.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); nenet 399/2, pika 1, shkronja "b", 399/3, pika 1, 399/4, pika 2, 399/7, pika 3, të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska dhe mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Afroviti Xufa, në datën 9.2.2011, i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi kundër disa shtetasve, një shoqërie tregtare dhe disa institucioneve shtetërore, me objekt: - anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 9, datë 3.2.2009, të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Vlorë, në lidhje me pasurinë nr. 35/41, truall me sipërfaqe 832,8 m^2, nga e cila 28 m^2 ndërtesë; - konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nr. 1286 rep., nr. 680 kol., datë 13.4.2010; - detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të fshijë pronën në emër të të paditurve dhe regjistrimin e saj në emër të kërkueses; - anulimin e lejes së sheshit dhe të ndërtimit; - marrjen e masës së sigurimit të padisë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 349, datë 26.2.2015, ka pranuar padinë sipas objektit të saj, duke rrëzuar kërkesën për sigurimin e padisë (bllokimin e pasurisë së mbivendosur pranë ZVRPP Vlorë dhe pezullimin e punimeve nga shoqëria ndërtuese e paditur). Mbi ankimin e palës së paditur, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1255, datë 23.11.2016, ka prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe i ka dërguar çështjen asaj për rigjykim. Më pas, mbi rekursin e palës së paditur, çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11243-01576-00-2017, datë 7.5.2017.

3. Ndërkohë që çështja ishte në pritje për t'u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë, kërkuesja, në datat 7.11.2023 dhe 17.1.2024, ka paraqitur dy kërkesa për përshpejtimin e shqyrtimit të saj. Meqenëse çështja nuk është planifikuar për gjykim, në datën 25.11.2024, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimin e procedurave të gjykimit, në bazë të neneve 399/5 dhe 399/6, pika 1, shkronja "c", të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*. Kërkesa është shqyrtuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili, me vendimin nr. 00-2025-61, datë 16.1.2025, ka vendosur pushimin e gjykimit të saj,

me arsyetimin se çështja civile ishte planifikuar për t'u shqyrtuar në dhomë këshillimi në datën 29.1.2025. Në vlerësimin e Kolegjit Administrativ, meqenëse Kolegji Civil kishte marrë masat për shqyrtimin e çështjes, kërkesa për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm kishte mbetur pa objekt dhe duhej pushuar, sipas nenit 399/7, pika 3, të KPC-së.

4. Në datën 9.6.2025 (sipas shërbimit postar), kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual, sipas objektit të mësipërm. Kolegji i Gjykatës, në datën 15.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Përpara seancës plenare, në datën 18.11.2025, kërkuesja ka kërkuar edhe shpërblimin e shpenzimeve gjyqësore në vlerën 50.000 lekë.

5. Pas kalimit të çështjes në seancë plenare dhe pak ditë përpara zhvillimit të saj në datën 20.11.2025, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen civile të kërkueses. Sipas të dhënave në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit të datës 5.11.2025 dhe Kolegji Civil ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1255, datë 23.11.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, me argumentet si vijon:

6.1 Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen e saj brenda 2-vjeçar të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së. Ky shqyrtim tashmë ka zgjatur më shumë se 8 vjet, pa qenë kërkuesja shkak i zvarritjes, ndërkohë që çështja nuk paraqitet komplekse dhe reforma në drejtësi nuk mund të përdoret si justifikim për vonesën. Zvarritja e gjykimit rrezikon gëzimin e së drejtës së pronës nga kërkuesja, e cila është 84 vjeç.

6.2 Edhe pse gjykimi i kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm u pushua për shkak të planifikimit të datës së shqyrtimit të çështjes, në fakt çështja nuk u shqyrtua në datën e planifikuar dhe as është caktuar një datë e re për shqyrtimin e saj. Në këtë mënyrë kërkueses iu mohua edhe mundësia për të kërkuar shpërblimin e dëmit për shkeljen e afatit të arsyeshëm sipas nenit 399/4, pika 2, të KPC-së.

6.3 Kohëzgjatja tërësore e procedurave të gjykimit të çështjes në të gjitha shkallët gjyqësore tashmë ka kaluar tejkaluar 14 vjet dhe rrezikon të dyfishohet në rast të kthimit të çështjes në shkallë të parë.

6.4 Parashikimi i lidhëzës "/ose" në pikën 1, të nenit 399/3 të KPC-së dhe fjalia "dhe nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen vendimi i gjykatës, sipas pikës 1 të këtij neni" në nenin 399/4, pika 2, të KPC-së, janë formalizma të tepruara që cenojnë në thelb të drejtën e individit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj janë të papajtueshme me Kushtetutën. Këto parashikime ligjore e bëjnë joefektiv mekanizimin e parashikuar për mbrojtjen e afatit të arsyeshëm, në kundërshtim me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së, pasi individi mund të kërkojë shpërblimin e dëmit vetëm mbi bazën e vendimit që konstaton shkeljen e afatit të arsyeshëm dhe urdhëron përshpejtimin e procedurave, por jo në rastin e pushimit të gjykimit për shkak të marrjes së veprimeve të kërkuara nga individi.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesja ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka pushuar gjykimin e kërkesës së saj për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimin e procedurave, si dhe përmbajtjen e neneve 399/3, pika 1, dhe 399/4, pika 2, të KPC-së. Ajo pretendon se vendimi dhe dispozitat ligjore i kanë cenuar të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

9. Gjykata ka theksuar se, në zbatim të neneve 49, pika 3, shkronja "e" dhe 71, pika 2, të ligjit organik, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë, krahas vendimit gjyqësor, edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, kërkuesi legjitimohet nëse janë plotësuar bashkërisht këto kritere: i. legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që kërkuesi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, përveç edhe interesin e tij për çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; ii. shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të aktit të kundërshtuar; iii. legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; dhe iv. legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që kërkuesi provon se e drejta e pretenduar e cenuar bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe rivendosja e saj është e mundur nga shqyrtimi kushtetues i çështjes *(shih vendimet nr. 85, datë 24.12.2024; nr. 34, datë 12.6.2023; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

10. Për sa i takon kriterit për legjitimimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi është subjekt i kushtëzuar. Si i tillë, ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2024; nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese).*

11. Në rastin konkret, kërkuesja është palë ndërgjyqëse në procesin civil ku ajo pretendon cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, pasi justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

12. Për dispozitat ligjore të kundërshtuara, Gjykata konstaton se nenet 399/3, pika 1 dhe 399/4, pika 2, të KPC-së rregullojnë konceptin e shpërblimit të drejtë për shkeljen e afatit të arsyeshëm dhe kompetencën për gjykimin e kërkesëpadive për shpërblimin e dëmit sipas nenit 399/6, pika 3, të KPC-së. Gjykata ka pohuar se, në parim, pretendime të kësaj natyre duhet të analizohen të lidhura ngushtësisht me vendimet gjyqësore të dhëna bazuar në dispozitën ligjore të kundërshtuar *(shih vendimin nr. 12, datë 24.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë rast, kërkuesja nuk është palë në një proces gjyqësor për shpërblimin e dëmit në kuptim të neneve 399/3, pika 1 dhe 399/4, pika 2, të lidhura me nenin 399/6, pika 3, të KPC-së. Për rrjedhojë, për sa kohë që cenimi i pretenduar i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm nuk lidhet me zbatimin e dispozitave ligjore të kundërshtuara, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione personae* për kërkimin që synon kontrollin kushtetues të tyre, pasi nuk justifikon interesin e saj real dhe të drejtpërdrejtë. Për rrjedhojë, kërkimi për shfuqizimin e dispozitave ligjore nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit organik të Gjykatës, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual pasi ka përdorur mjetin juridik parandalues/përshpejtues të parashikuar nga KPC-ja. Ajo ka kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe/ose përshpejtimin e procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë, në bazë të neneve 399/5 dhe 399/6, pika 1, shkronja "c", të KPC-së, për të cilën ajo gjykatë ka vendosur pushimin e gjykimit. Në ankimin kushtetues individual, ajo ankohet si për kohëzgjatjen e gjykimit në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe për kohëzgjatjen e procesit civil në tërësi, duke ngritur pretendime edhe për mungesën e efektivitetit të mjeteve të parashikuara nga KPC-ja për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

14. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* ka pranuar se neni 13 i KEDNJ-së i lejon një shteti të zgjedhë midis një mjeti "parandalues ose përshpejtues", i projektuar për të përshpejtuar procedurat në mënyrë që të parandalojë që ato të tejzgjasin dhe një mjeti "riparues, kompensues ose monetar" që parashikon korrigjimin *ex post facto* për

vonesat që kanë ndodhur tashmë, qoftë edhe nëse procedura është ende në shqyrtim. Ligjvënësi shqiptar ka parashikuar një zgjidhje të kombinuar përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese, në nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Ky mekanizëm është vlerësuar, në parim, si efikas edhe nga GJEDNJ-ja, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur *(shih vendimet nr. 58, datë 17.9.2024; nr. 11, datë 28.2.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

15. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesja, në datën 25.11.2024, ka përdorur mjetin parandalues/përshpejtues, por gjykimi i kërkesës së saj është pushuar me vendimin e datës 16.1.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se çështja civile do të shqyrtohej në datën 29.1.2025 (*shih supra paragrafin 3*). Megjithatë, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Lartë, por edhe të dhënave në faqen zyrtare të saj, çështja e kërkueses nuk është është shqyrtuar në datën e planifikuar, për shkak të pengesës ligjore të trupit gjykues. Ajo është planifikuar për në datën 17.9.2025, por sërish nuk është shqyrtuar për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Çështja është shqyrtuar vetëm në datën 5.11.2025 dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1255, datë 23.11.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në këto rrethana, çështja civile e kërkueses është shqyrtuar pas 8 vjet e 6 muaj nga regjistrimi i saj në Gjykatën e Lartë dhe pas gati 1 viti nga përdorimi prej saj të mjetit parandalues dhe përshpejtues, duke përfunduar me dërgimin e saj për rishqyrtim në gjykatën e apelit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mjetet juridike nuk kanë qenë efektive për përshpejtimin e procedurave dhe kërkuesja nuk ka më mjete juridike efektive në dispozicion, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

16. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis,* në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit organik të Gjykatës, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe se vendimi i Gjykatës së Lartë objekt ankimi i është njoftuar përfaqësuesit të kërkueses në adresën elektronike në datën 11.2.2025, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 9.6.2025 (sipas shërbimit postar), pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja pretendon cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, i cili *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

18. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen civile të saj brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së. Ky shqyrtim tashmë ka zgjatur më shumë se 8 vjet, pa qenë ajo shkak i zvarritjes, ndërkohë që çështja nuk paraqitet komplekse dhe reforma në drejtësi nuk mund të përdoret si justifikim për vonesën. Zvarritja e gjykimit rrezikon gëzimin e së drejtës së pronës, ndërsa ajo është 84 vjeç. Sipas saj, pushimi i gjykimit të kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit për shkak të planifikimit të një date gjykimi, e cila në fakt nuk u respektua, e ka privuar nga e drejta për të kërkuar shpërblimin e dëmit sipas nenit 399/4, pika 2, të KPC-së. Ajo thekson se kohëzgjatja tërësore e procesit ka kaluar 14 vjet dhe mund të dyfishohet në rast të rikthimit të çështjes në shkallë të parë.

19. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit llogaritet nga momenti i fillimit të procesit deri në dhënien e vendimit, duke përfshirë edhe vonesat e lidhura me reformën në drejtësi, të cilat nuk mund të rëndojnë mbi palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 15, datë 3.4.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Në rastin konkret, mosmarrëveshja që po gjykohet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm lidhet me të drejtën e pronës, në kuadrin e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave. Procesi është vënë në lëvizje nga kërkuesja në datën 9.2.2011 dhe në shkallë të parë ka përfunduar në datën 26.2.2015, në favor të kërkueses, por pa pranuar sigurimin e padisë. Në apel çështja ka përfunduar në datën 23.11.2016, por pa vendim përfundimtar, ndërsa ajo është kthyer për rigjykim në shkallë të parë. Para se rigjykimi të vijonte, pala kundërshtare

e kërkueses ka paraqitur rekurs dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 7.5.2017. Përpjekjet e kërkueses për përshpejtim (kërkesat e datave 7.11.2023 dhe 17.1.2024) nuk kanë sjell rezultat. Në datën 25.11.2024, ajo ka përdorur mjetin parandalues dhe përshpejtues, por Gjykata e Lartë ka pushuar gjykimin e kësaj kërkese, duke u mbështetur në planifikimin për shqyrtimin e çështjes civile. Në fakt, për shkak të pengesave ligjore dhe mosformimit të trupit gjykues, çështja është shqyrtuar vetëm në datën 5.11.2025, duke u dërguar për rishqyrtim në gjykatën e apelit, e cila tashmë duhet të shqyrtojë sërish çështjen.

21. Gjykata konstaton se shqyrtimi i çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë ka tejkaluar dukshëm afatin 2-vjeçar të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, përfshirë edhe zgjatjen e tij me 1 vit e 6 muaj të parashikuar në dispozitën kalimtare (neni 109, pika 4, shkronja "b") të ligjit ndryshues të KPC-së (ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017), i zbatueshëm në rastin konkret.

22. Në analizën e afatit të arsyeshëm, Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave vlerësohet nën dritën e këtyre kritereve: i. sjellja e kërkuesit; ii. kompleksiteti i çështjes; iii. sjellja e autoriteteve; iv. rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 15, datë 3.4.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në lidhje me kriterin e fundit, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se duke pasur parasysh atë që është në rrezik për kërkuesin, disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" nevojitet të trajtohen me shpejtësi e përparësi, të tilla si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuesit verifikohet rast pas rasti *(shih vendimet nr. 43, datë 4.6.2024; nr. 21, datë 4.4.2024; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese).* Megjithatë, kur kohëzgjatja e gjykimit ka qenë e konsiderueshme, Gjykata ka gjetur shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm edhe në rastet që nuk kërkonin ndonjë trajtim të veçantë me përparësi, të tilla si mosmarrëveshjet për të drejtën e pronës të lidhura me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave *(shih vendimin nr. 46, date 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese).*

24. Duke verifikuar zbatimin e këtyre kritereve dhe standardeve kushtetuese në rastin konkret, Gjykata konstaton fillimisht se Gjykata e Lartë në vendimin e kundërshtuar, ndonëse i ka evidentuar kriteret e vlerësimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, nuk ka bërë asnjë vlerësim konkret në raport me rrethanat e çështjes së kërkueses. Në këto rrethana, Gjykatës i kërkohet të verifikojë vetë këto kritere mbështetur në jurisprudencën e saj dhe atë të GJEDNJ-së.

25. Gjykata vëren se duhet të shqyrtojë kohëzgjatjen e procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë, konkretisht periudhën nga data 7.5.2017 e regjistrimit të çështjes në atë gjykatë dhe deri në datën 5.11.2025, të përfundimit të shqyrtimit të saj. Po ashtu, ajo duhet të shqyrtojë edhe kohëzgjatjen tërësore të procedurave të gjykimit në të gjitha shkallët e gjykimit. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se KPC-ja ka parashikuar jo vetëm kohëzgjatjen që konsiderohet e arsyeshme për secilën shkallë të procesit, por edhe të drejtën e individit palë në procedura që të përdorë mjetet parandaluese në secilën shkallë gjykimi. Edhe pse sipas ligjit zgjidhja përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese zbatohet për çdo shkallë dhe fazë të veçantë të procesit, kohëzgjatja e procedurave në secilën shkallë vlerësohet edhe në raport me kohëzgjatjen tërësore të procesit. Po sipas saj, edhe pse vlerësimi i kërkesave për shkelje të afatit të arsyeshëm, në kuptim të parashikimeve procedurale të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, bëhet në përputhje me rrethanat konkrete të çdo çështjeje të veçantë, kohëzgjatjen tërësore të saj dhe pasojat e kësaj kohëzgjatjeje në të drejtat e kërkuesit, qëllimi parësor i këtyre mjeteve juridike është njohja e shkeljes së kërkesës për "afat të arsyeshëm" dhe parandalimi i zgjatjes në mënyrë të tepruar të afatit të procesit përmes përshpejtimit të tij dhe, në enventualitet, korrigjimi i vonesave të ndodhura përmes shpërblimit të demit *(shih vendimin nr. 11, datë 28.2.2025, të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Për sa i takon *sjelljes së kërkueses*, Gjykata konstaton se ajo nuk ka kontribuar në vonesa, përkundrazi, kërkuesja ka kërkuar në mënyrë aktive përshpejtimin e procedurave. Nuk ka ndonjë rrethanë që të tregojë se kërkuesja është bërë shkas për tejzgjatjen e procedurave të gjykimit të çështjes së saj në Gjykatën e Lartë.

27. Për sa i përket *kompleksitetit të çështjes*, Gjykata vëren se ajo nuk paraqitet veçanërisht komplekse për nga objekti i kontrollit të Gjykatës së Lartë, ndërsa ai ka konsistuar në ligjshmërinë e një vendimi

jopërfundimtar të gjykatës së apelit për kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, çka nuk kërkon një shqyrtim të gjerë, sikurse edhe në fakt ka ndodhur, kur Gjykata e Lartë e ka përfunduar shqyrtimin brenda një seance. Në këtë kuptim, çështja nuk paraqitet komplekse, duke mos qenë ajo shkaku i tejzgjatjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë.

28. Për sa i takon *sjelljes së autoriteteve*, Gjykata vëren se vonesa në fakt duket se, kryesisht, lidhet me mbingarkesën e Gjykatës së Lartë. Sipas informacionit të dërguar nga kjo e fundit, deri në datën 31.10.2025, pranë saj janë të regjistruara 12.043 çështje civile, ndërkohë që ngarkesa e gjyqtarit relator të çështjes së kërkueses është 2122 çështje në shqyrtim.

29. Gjykata ka vlerësuar më parë se tejzgjatja e procedurave gjyqësore lidhet kryesisht me ngarkesën e lartë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si pasojë e reformës në drejtësi. Megjithatë, pavarësisht rëndësisë së kësaj reforme, ligjvënësi dhe organet përgjegjëse duhet të marrin masa për të siguruar funksionimin normal të gjykatave dhe zbatimin e ligjit. Kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi kushtetues përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1–399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë *(shih vendimet nr. 58, date 17.9.2024; nr. 61, datë 20.11.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja, ka pranuar sfidat e rëndësishme me të cilat është përballur gjyqësori shqiptar pas reformave të ndërmarra në dekadën e fundit, përfshirë edhe si rezultat i verifikimit të gjyqtarëve dhe vonesat nga autoritetet emëruese në plotësimin e vendeve të lira të krijuara në këtë mënyrë, përveç edhe përparimin domethënës në fusha të caktuara, në veçanti me uljen e vazhdueshme të numrit të madh të çështjeve të prapambetura që ishin në pritje para Gjykatës së Lartë në vitin 2020 dhe shkallën në rritje të zgjidhjes së çështjeve të vërejtura në disa vitet e fundit. Megjithatë, ajo ka vërejtur se kohët mesatare të përpunimit të çështjeve ende duken të konsiderueshme në gjykatën më të lartë kombëtare për të gjitha llojet e çështjeve. Këta faktorë të një natyre të përgjithshme, mund të merren parasysh nga Gjykata, në një masë të përshtatshme, në përcaktimin e çdo kohëzgjatjeje të tepërt të procedurave në një rast të veçantë. Në të njëjtën kohë, ato nuk janë të afta, më vete, të justifikojnë vonesa të një madhësie si ajo me të cilën është përballur kompania aplikuese në rastin aktual *(shih ARB sh.p.k. dhe të tjerëve kundër Shqipërisë, 2025, §§ 121–122)*.

31. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkueses në Gjykatën e Lartë ka ardhur për shkak të sjelljes së autoriteteve.

32. Për sa i përket rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja, Gjykata vëren se, edhe pse çështja nuk hyn në kategorinë e interesave "jetësore" që kërkojnë trajtim me përparësi, ajo lidhet me të drejtën e pronës dhe proceset e kthimit dhe kompensimit të pronave, ku Gjykata ka konstatuar më parë shkelje të afatit të arsyeshëm. Për më tepër, jo vetëm për shkak të asaj kohëzgjatje tërësore të procedurave në rastin konkret, por edhe rrethanave të veçanta të rastit, duket se çështja ka kërkuar trajtim me përparësi. Në këtë drejtim, përveç moshës së kërkueses, vlen të përmendet se procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë konsistonte në kontrollin e një vendimi jopërfundimtar të gjykatës së apelit, i cili pengonte zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, çka justifikonte trajtimin e saj me përparësi, në përputhje edhe me orientimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", i nxjerr sipas delegimit të nenit 460, pika 4, të KPC-së dhe i zbatueshëm edhe për planifikimin e gjykimeve në Gjykatën e Lartë, referuar nenit 480, pika 2, të KPC-së.

33. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja është shprehur se njeh, në përputhje me përfundimet e Gjykatës Kushtetuese se, ndërsa merren me çështje të prapambetura të konsiderueshme dhe kërkojnë të sigurojnë trajtim të drejtë të të gjitha çështjeve në pritje, gjykatat kombëtare mund të kenë hapësirë të kufizuar për të përdorur mjetet juridike përshpejtuese të parashikuara nga ligji kombëtar në çështjet joprioritare. Pavarësisht kësaj, Shteti i paditur është ende i detyruar të ofrojë një mjet efektiv kompensues në rrethana të tilla. *(shih ARB sh.p.k. dhe të tjerëve kundër Shqipërisë, 2025, § 122)*.

34. Në këto rrethana, duke pasur parasysh vonesën prej 8 vitesh e 6 muajsh para Gjykatës së

Lartë, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkueses në këtë gjykatë ka tejkaluar afatin e arsyeshëm në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Mjetet e parashikuara nga KPC-ja për parandalimin dhe korrigjimin e shkeljes së afatit në rastin konkret nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe sjellja e autoriteteve ka sjellë cenim të së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

35. Në kushtet kur gjykimi i çështjes së kërkueses tashmë ka përfunduar në Gjykatën e Lartë, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së si më lart, Gjykata vëren se mbetet të konstatohet vetëm cenimi i së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, njohje e shkeljes kjo, që sipas KPC-së, do t'i mundësonte kërkueses përdorimin efektiv të mjetit kompensues. Në këtë drejtim, Gjykata mban në konsideratë se, në parim, statusi i "viktimës" përjashtohet vetëm nëse organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur ose në substancë, dhe më pas e kanë riparuar atë. Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave të gjykimit, çështja nëse kërkuesi ka marrë shpërblim të drejtë, është një çështje e rëndësishme dhe vendimi gjyqësor që cakton shpërblimin e drejtë përbën korrigjim të mjaftueshëm, rast në të cilin individi nuk mund të pretendojë më se është viktimë e shkeljes (*shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkesa e kërkueses pranohet vetëm për sa i përket konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

C. Për shpenzimet e përfaqësimit në Gjykatën Kushtetuese

37. Kërkuesja, me shkresën e datës 18.11.2025, përpara seancës plenare, bazuar në nenin 28 të ligjit organik të Gjykatës, ka kërkuar edhe pagimin e shpenzimeve gjyqësore për përgatitjen e ankimit kushtetues individual nga avokati i saj, duke paraqitur për këtë si provë faturën tatimore të datës 17.11.2025, lëshuar nga përfaqësuesi i saj, avokati Thomas Dhimolea, në vlerën 50,000 lekë (pa TVSH), me përshkrimin pagesë për ofrimin e shërbimit të përgatitjes së ankimit kushtetues individual.

38. Gjykata vëren se neni 28 i ligjit organik të saj parashikon rregullat për shpenzimet gjyqësore. Sipas këtij neni, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (pika 1); ndërsa, kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, Gjykata mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit, pjesërisht ose tërësisht, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (pika 2). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, sipas të cilit kërkesa shoqërohet me aktin që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (pika 2); si dhe, në rast pranimi të ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (pika 4).

39. Gjykata ka theksuar se, në parim, çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe se refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë, në mënyrë të pajustifikuar, të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Sipas saj, në interpretim të dispozitave ligjore, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri në momentin e deklarimit të mbylljes së seancës plenare. Individi, është shprehur Gjykata, ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe janë në masë të arsyeshme, duke paraqitur ai aktet që dokumentojnë masën e shpenzimeve të kryera për qëllime të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të shoqëruara me fatura tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Gjykata është shprehur se kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të tij, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar *(shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese).*

40. Në lidhje me subjektin të cilit i ngarkohen shpenzimet e përfaqësimit, Gjykata është shprehur se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm. Në gjykimin kushtetues, individi synon të mbrojë të drejtat themelore të cenuara si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, ndaj përgjegjësia për mbulimin e këtyre shpenzimeve i takon vetë shtetit. Kjo logjikë pasqyrohet edhe në rregullimet ligjore për kompensimin e shkeljes së të drejtës për gjykim

brenda afatit të arsyeshëm, ku në gjykimin e zakonshëm thirren si të paditura Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (neni 399/4, pika 2, i KPC-së) *(shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese).*

41. Mbi bazën e këtyre standardeve, Gjykata vëren se kërkimi i kërkueses për shpenzimet gjyqësore është paraqitur në formën e kërkuar dhe brenda afatit ligjor, pasi është depozituar me shkrim përpara seancës plenare. Po ashtu, shpenzimet e kërkuara gjyqësore kanë qenë të nevojshme, pasi lidhen me përgatitjen e ankimit kushtetues individual, të cilin, në mungesë të përvojës juridike të kërkueses për të kuptuar çështjen, por edhe moshën e saj, ajo nuk mund ta përgatiste vetë. Për sa i përket vërtetimit të shpenzimeve gjyqësore kërkuesja ka paraqitur faturën tatimore të lëshuar nga avokati, në të cilën përshkruhet shërbimi i ofruar dhe vlera e tij në masën 50 000 lekë. Megjithatë, duke mbajtur parasysh se çështja e përfunduar me këtë vendim nuk paraqitet komplekse, masa e arsyeshme e kompensimit të shpenzimeve të kërkueses për përgatitjen e ankimit kushtetues individual çmohet të jetë në vlerën 25 000 lekë, vlerë kjo e parashikuar edhe nga udhëzimi i përbashkët nr. 18, datë 5.8.2020, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, "Për miratimin e kritereve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore", në lidhje me shërbimin juridik jashtëgjyqësor (përgatitje kërkese në Gjykatë). Këto shpenzime, duke pasur parasysh natyrën e çështjes konkrete, e cila lidhet me konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, i ngarkohen Ministrisë së Financave. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe pranohet vetëm për vlerën e 25 000 lekë[15].

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses janë të bazuara sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI**:**

1. Pranimin e pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-61, datë 16.1.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkueses në vlerën 25 000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.11.2025.
Shpallur më 24.12.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Marjana Semini

VENDIM
Nr. 00-2024-5509 (214), datë 14.5.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Sokol Sadushi	kryesues;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Gentian Medja	anëtar;
Enkelejda Metaliaj (Softa)	anëtare,

dhe sekretare gjyqësore Katerina Bilo, në seancë gjyqësore datë 14.5.2024, mori në shqyrtim, çështjen administrative nr. 30004-00129-00-2023 akti, që i përket:

PADITËS: Ibrahim Topçiu

[15] Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për pranimin e të gjithë shumës së kërkuar.

TË PADITUR: Këshilli i Ministrave
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Autoriteti Rrugor Shqiptar

OBJEKTI: Shfuqizim të pjesshëm të VKM-së nr. 795, datë 22.9.2015, "Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë (lotet I, II)", në lidhje me vlerën e dëmshpërblimit nga shpronësimi i pronës së paditësit.

Shpërblimin e paditësit me çmimin e tregut për shpronësimin e sipërfaqes prej 2.299 m^2 të pasurisë së paluajtshme nr. 528/5, ZK 2529, vol. 10, arë me sipërfaqe 8.100 m^2, ndodhur në Lundër, Tiranë, në vlerën 8.046.500 (tetë milionë e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind) lekë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32/a, 36, 43, 153, 154, 156 të Kodit të Procedurës Civile; nenet 7/a, 11/1, 15/a, 17/1/a, 18/1/c të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar; nenet 2, 4, 17, 19, 23, 24 të ligjit nr. 8651, datë 22.19.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interesa publikë"; VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurisë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar; nenit 41 të Kushtetutës së Shqipërisë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË,

Pasi u relatua çështja administrative prej gjyqtares relatore, Arbena Ahmeti, dëgjoi palën rekursuese të përfaqësuar prej avokatit Korab Cani, që kërkoi prishjen e vendimin të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues, palën e paditur të përfaqësuar prej Avokaturës së Shtetit, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe si e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 795, datë 22.9.2015, "Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë (lotet I, II)", ka miratuar shpronësimin e pronave përkatëse që preken nga realizimi i projektit, duke përcaktuar për secilën pronë masën përkatëse të shpërblimit.

2. Vendimi i shpronësimit ka përfshirë edhe pasurinë e regjistruar në emër të paditësit, për të cilën është përcaktuar masa kompensuese në shumën 1.029.952 (një milion e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) lekë. Për pasurinë me sipërfaqe 2299 m^2, e llojit "tokë arë" ndodhur në Lundër, Tiranë, është përcaktuar çmimi prej 448 lekë/m^2, duke u llogaritur në total vlera shpronësuese e mësipërme. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 795/2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 170, datë 30.9.2015.

3. Paditësi, duke kundërshtuar masën e kompensimit, të përcaktuar në vendimin e mësipërm të shpronësimit, ka paraqitur padi në gjykatën kompetente më datë 14.11.2015.

4. Nga aktet e administruara në gjykim rezulton se paditësi është vënë në dijeni të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 795/2015 më datë 15.10.2015.

5. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë,** me vendimin nr. 1760 (1776), datë 13.4.2016 ka vendos: *"Rrëzimin e padisë (...)"*

5.1. Gjykata ka shqyrtuar mosmarrëveshjen në themel dhe ka arsyetuar, se: "(...) *çmimi i përcaktuar në VKM është çmimi i tregut, çmimi mesatar i shitjes së pronës së paluajtshme, është mesatarja e vlerës së tregut për periudhën përkatëse, si rrjedhojë kërkesa e paditësit për vlerësim me çmim tregu është plotësuar. Për rrjedhojë, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me përcaktime arbitrare të vlerës së pronës, por me caktimin e vlerës së pronës së shpronësuar në bazë të një metodike dhe procedure të përcaktuar në mënyrë të qartë në këto akte ligjore. Prona e paditësit është shpronësuar sipas VKM-së nr. 795/2015, duke u bazuar në zërin kadastral të pasurisë, e cila është e llojit "arë" dhe mbi këtë kategori është përcaktuar dhe vlera për kompensim, e cila përfaqëson dhe vlerën e saktë të shpronësimit të paditësit edhe sipas konkluzioneve të aktit të ekspertimit, sipas të cilit rezultoi e provuar se nuk ekziston diferencë midis vlerës së përcaktuar sipas VKM-së dhe vlerës së akorduar si kompensim nga pala*

e paditur, madje rezulton që të ketë përfituar 34485 lekë më shumë."

6. Kundër vendimit ka paraqitur **ankim** pala paditëse, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë. Ankimi i është njoftuar palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit, të cilët dhe nuk kanë paraqitur kundërankim.

7. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 466, datë 10.11.2022, ka vendosur*: "Prishjen e vendimit nr. 1760, datë 13.4.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e çështjes. (...)".*

7.1. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se: *"(...) vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë pa u verifikuar sipas nenit 18 të ligjit nr. 49/2012, kushti formal i afatit të paraqitjes së padisë, afat i cili ... nuk është respektuar nga paditësi, dhe, për rrjedhojë, në bazë të nenit 50/d të ligjit nr. 49/2012 vendimi duhet të prishet dhe çështja të pushohet. Në lidhje me nisjen e afatit, përveç sa parashikon neni 24/1 i ligjit të posaçëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin në një sërë praktikash (shih vendimet 64, datë 21.2.2022, 66, datë 21.2.2022, 113, datë 21.3.2022 dhe 223, datë 2.6.2022), se afati për ngritjen e padisë nis nga botimi i vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave në Fletoren Zyrtare. Në këto kushte, në gjykimin në shkallë të parë rezulton se VKM-ja nr. 795/2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 170, datë 30.9.2015; padia është paraqitur nga paditësi me anë të shërbimit postar më datë 14.11.2015, pra ... dukshëm jashtë afatit të ngritjes së padisë. Paditësi ka pretenduar se është vënë në dijeni të VKM-së nr. 795/2015, më datë 15.10.2015, por ky fakt sipas trajtimit që bën Gjykata e Lartë është irrelevant."*

8. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ ka ushtruar ***rekurs të veçantë***, me datë 27.1.2023, pala paditëse, që kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Me anë të rekursit kërkohet ndryshimi i vendimit dhe pranimi i padisë, duke parashtruar si shkaqe, në mënyrë të përmbledhur:

- E drejta e padisë është ushtruar në përputhje me ligjin e posaçëm prej 30 ditëve nga marrja dijeni për vendimin e shpronësimit (neni 24). Ndryshe nga sa argumenton Gjykata Administrative e Apelit, kjo dispozitë nuk ka asnjë përplasje me nenin 21, paragrafi 5. Ajo çfarë parashikon neni 21, paragrafi 5, hyrja në fuqi menjëherë e VKM-së, përforcohet me paragrafin 2 të nenit 24 të ligjit, ku parashikohet se ankimi ndaj vendimit të shpronësimit, nuk e pezullon atë. Pra që vendimi i shpronësimit hyn në fuqi menjëherë.

- Detyrimi për të publikuar në Fletoren Zyrtare të vendimit, sipas nenit 21, paragrafi 5, nuk e shfuqizon detyrimin e organit administrativ për të njoftuar drejtpërdrejtë pronarin e shpronësuar, sipas nenit 24, paragrafi 1, i po këtij ligji.

- Gjykata Administrative e Apelit, në mënyrë krejt të gabuar, në kundërshtim me ligjin e posaçëm të shpronësimit nr. 8561, datë 22.12.1999, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin nr. 49/2012, e transferon barrën e provës për marrjen dijeni dhe argumenton se paditësi "prezumohet se ka marrë dijeni", me publikimin në Fletore Zyrtare të VKM-së nr. 795/2015.

- Gjykata Administrative e Apelit nuk mundet në asnjë rast të interpretojë ligjin në një mënyrë të tillë që *de facto* të shfuqizojë një dispozitë ligjore. Ligji i posaçëm i shpronësimit, nuk ka asnjë mangësi apo vakum ligjor, për sa i përket detyrimit për të njoftuar aktin administrativ të shpronësimit, si dhe të drejtën e qytetarit për ankim ndaj këtij akti. Neni 24, paragrafi 1 i ligjit të sipërcituar e ka parashikuar shumë qartë detyrimin e njoftimit në mënyrë të drejtpërdrejtë të aktit të shpronësimit, si dhe të drejtën e qytetarit që të ankimojë në gjykatë këtë akt, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për aktin. Në rastin tonë, padia është ngritur brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për VKM-në nr. 795/2015.

- Gjykata Administrative e Apelit ka cenuar të drejtën e paditësit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Kjo çështje gjyqësore është regjistruar më datë 20.10.2016 në Gjykatën Administrative të Apelit, ndërkohë vendimi mban datën 10.11.2022. Pra, gjykatës iu deshën mbi 6 (gjashtë) vjet për t'u shprehur për ankimin e paditësit. Ky afat shkon përtej çdo afati që mund të quhet "i arsyeshëm", sipas ligjit dhe praktikës gjyqësore shqiptare dhe ndërkombëtare.

9. **Me vendim të gjyqtarit të vetëm, datë 2.2.2023, Gjykata Administrative e Apelit** ka vendosur "*Pranimin e rekursit"*. Janë kryer njoftimet përkatëse dhe nuk rezulton të jetë depozituar kundërrekurs prej palëve të paditura apo prej Avokaturës së Shtetit.

10. Fashikulli gjyqësor dhe aktet procedurale janë regjistruar në Gjykatën të Lartë për kompetencë shqyrtimi, më datë 7.3.2023.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

- Mbi procedurën për njësimin e praktikës gjyqësore

11. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë *(në vijim "Kolegji")* me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, më datë 24.4.2023 kreu veprimtarinë seleksionuese dhe vlerësoi ta planifikojë më pas për shqyrtim në dhomë këshillimi, për arsye se çështja me objekt rekursi vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, që ka prishur vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë dhe ka pushuar gjykimin, përfshihet në kategorinë e çështjeve prioritare.

12. Gjatë shqyrtimit në dhomë këshillimi, më datë 15.6.2023, Kolegji mori vendim të ndërmjetëm, në zbatim të nenit 62/a, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 49/2012") për nisjen e procedurës së njësimit të praktikës gjyqësore, duke kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore. Vendimi i ndërmjetëm, datë 23.7.2024, mbi nisjen e procedurës për njësimin e praktikës gjyqësore administrative, ku jepen arsyet përkatëse është njoftuar me anë të publikimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Kolegji shtroi për njësim pyetjen:

- Në cilin moment lind e drejta e padisë administrative për kundërshtimin e vlerës së pronës, objekt shpronësimi për interes publik me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave?

- Zhvillimi i legjislacionit dhe ecuria e praktikës gjyqësore

13. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012 dhe në bazë të Dekretit të Presidentit të Republikës, më datë 4.11.2013, nisën funksionin gjykatat administrative. Më parë, çështjet administrative gjykoheshin nga seksionet administrative pranë gjykatave përkatëse, si një ndër format e gjykimit të posaçëm referuar neneve 324–333 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Për rrjedhojë, praktika e analizuar në vijim, i përket Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (KCGJL), para nëntorit të vitit 2013 dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (KAGJL), pas kësaj date.

14. Ligji nr. 49/2012, në nenin 18 përcakton rregullat për llogaritjen e afatit të padisë administrative, si një ndër kushtet formale që gjykatat administrative duhet të verifikojnë. Madje referuar parashikimit të paragrafit të nenit 18, se: "Afatet e mësipërme janë të prera dhe shkelja e tyre shkakton humbjen e së drejtës së padisë", këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht. Praktika gjyqësore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji ka qenë e ndarë në dy drejtime: një qëndrim më i përhapur, sipas të cilit afatet e padisë duhet të verifikohen vetëm me kërkesën (prapësimin) e palës tjetër dhe një qëndrim tjetër, më i kufizuar, sipas të cilit afati 30-ditor i përcaktuar në nenin 328 të KPC-së për gjykimet administrative përbën afat dekadence, që duhet verifikuar kryesisht nga gjykata, pavarësisht nëse ekziston apo jo kërkesë nga pala e paditur.

15. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", u përcaktuan rregulla të reja mbi njoftimin dhe botimin e akteve administrative, ndër të tjera dhe publikimi i tyre në Fletoren Zyrtare si një mënyrë njoftimi. Edhe KPA-ja i vitit 1999 parashikonte këtë mënyrë, në nenet 60 dhe 114. Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorin të përkohshëm të pasurisë prone private për interesa publikë", i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8561/1999*)* përcakton në mënyrë të shprehur në nenin 21, se: "Vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësimin hyn në fuqi menjëherë." Gjithashtu, ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare". Nga ana tjetër, ligji nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", në nenin 29 përcakton, se: "Vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare"; ndërsa për vendimet me karakter individual përcakton, se: "hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare". Në vijim të këtij kuadri normativ, praktika gjyqësore është shprehur në mënyrë të ndryshme lidhur me momentin nga i cili nis të llogaritet afati i ankimit ndaj VKM-së së shpronësimit. Në vendimin nr. 1097, datë 7.7.2005, Kolegji Civil ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim, duke arsyetuar, se: "*Është interpretuar gabim nga gjykata neni 24 i ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, pasi nga përmbajtja e kësaj dispozite del qartë se afati 30-ditor i ankimit lidhet me momentin e marrjes dijeni të subjektit të shpronësuar... dispozita përcakton detyrime për ministritë kompetente që të njoftojnë drejtpërdrejt pronarët e shpronësuar. Në kuptim të nenit 12 të KPC-së barra për të provuar sa më sipër ka qenë e palës së paditur dhe ajo nuk ka mundur ta bëjë këtë*". Ky qëndrim u konfirmua më pas edhe në vendimin nr. 00-2010-1326(383), datë 14.10.2010, dhe në vendime të tjera pasuese të Kolegjit Civil, deri në kalimin e kompetencës lëndore tek Kolegji Administrativ në bazë të ligjit nr. 49/2012.

16. Në vendimin nr. 00-2017-797(164), datë 28.3.2017, Kolegji Administrativ, pasi ka marrë në shqyrtim nëse kërkesëpadia është depozituar apo jo në afat, ka arsyetuar se afati 30-ditor për paraqitjen e padisë sipas nenit 24/1 të ligjit nr. 8561/1999 fillon pas njoftimit të drejtpërdrejtë të subjektit të shpronësuar dhe marrjes dijeni të tij për vendimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë rast, pala e paditur nuk kishte provuar në gjykim se vendimi i ishte njoftuar paditësit, ndaj Kolegji konsideroi se padia ishte depozituar brenda afatit ligjor.

17. Në vendimin nr. 00–2022–559, datë 24.02.2022, KA-ja ka mbajtur qëndrimin e kundërt, duke vlerësuar se afati i padisë fillon me datën e botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare, bazuar në ligjin nr. 9000/2003 dhe dispozitat përkatëse të KPA-së. E njëjta linjë arsyetuese u mbajt edhe në vendimin nr. 00–2022–987(223), datë 2.6.2022, ku KAGJL-ja theksoi se botimi në Fletoren Zyrtare përbën një nga format e vlefshme të njoftimit sipas KPA-së, ligjit për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe ligjit për organizimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë vendim, Kolegji shtoi se qëllimi i njoftimit të drejtpërdrejtë është të garantojë që procedura e shpronësimit të mos zhvillohet pa dijeninë e pronarit, por kjo dijeni mund të realizohet edhe përmes formave të tjera të njoftimit, të vlefshme ligjërisht. I njëjti qëndrim si më lart është mbajtur në vendimin nr. 00-2022-287(62), datë 21.2.2022, vendimin nr. 00-2022-552(115), datë 21.3.2022, vendimin nr. 00-2022-516(113), datë 21.3.2022 vendimin nr. 00-2022-288(64), datë 21.2.2022, vendimin nr. 00-2022-283(66), datë 21.2.2022 të KA-së.

18. Në vendimin nr. 00-2022-818, datë 1.4.2022, KAGJL-ja thekson se botimi në Fletoren Zyrtare nuk është një procedurë formale, por moment kushtetues me rëndësi të veçantë, pasi nga kjo datë fillojnë efektet juridike të aktit dhe konsiderohet se ai i është bërë i njohur publikut, në përputhje me nenin 3 të ligjit nr. 96/2012, "Për Qendrën e Botimeve Zyrtare".

19. Në vendimin nr. 00-2022-2287, datë 22.9.2022, KAGJL-ja vlerësoi se kur në aktin administrativ mungon njoftimi i qartë për të drejtën dhe afatin e padisë, afati për paraqitjen e padisë zgjatet në një vit, në zbatim të nenit 18, pika 2 të ligjit nr. 49/2012. Në rastin konkret, Kolegji arriti në përfundimin se padia ishte paraqitur në mënyrë të rregullt brenda këtij afati njëvjeçar.

20. Në përfundim të analizës së mësipërme, Kolegji konstaton se në praktikën gjyqësore kanë bashkëjetuar, për një periudhë të zgjatur, qëndrime të ndryshme mbi momentin e nisjes së afatit të padisë në çështjet e shpronësimit: nga njëra anë, linja që e lidh afatin me njoftimin e drejtpërdrejtë dhe, nga ana tjetër, linja që e lidh me botimin në Fletoren Zyrtare. Kjo mospërputhje ka cenuar parashikueshmërinë dhe sigurinë juridike, duke krijuar pasiguri për organet publike dhe subjektet e shpronësuara. Për rrjedhojë, në ushtrim të funksionit nomofilatik dhe bazuar në nenin 62/a të LGJA-së, Kolegji me vendim të ndërmjetëm, datë 23.7.2024, ka vlerësuar nevojën mbi nisjen e procedurës për njësimin e praktikës gjyqësore administrative dhe përcaktimin e rregullit njësues lidhur me nisjen e afatit dhe barrën e provës mbi njoftimin.

21. Kolegji çmon të theksojë se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në vendimin nr. 26/2005, ka theksuar se "siguria juridike është ndër elementet thelbësorë të shtetit të së drejtës dhe se ajo presupozon besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe parashikueshmërinë e normave juridike".

22. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se siguria juridike që duhet të përcjellë rendi juridik lidhur me përdorueshmërinë dhe parashikueshmërinë normative duhet të jenë standard edhe për praktikën gjyqësore nomofilatike *(shih çështjen"Lupaş and Others v.Romania", ap. nos. 1434/02,35370/02 dhe 1385/03, paragrafi 67, ECHR 2006 XV).* Ajo ka pranuar se kundërshtitë e jurisprudencës janë të natyrshme dhe të qenësishme në të gjitha sistemet juridike, qoftë në gjykata të së njëjtës shkallë, qoftë në shkallë të ndryshme, apo qoftë edhe në autoritetin suprem më të lartë gjyqësor, duke konkluduar se kjo situatë nuk mund të jetë *apriori* në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, GJEDNJ-ja vlerëson se, për të konstatuar nëse ekziston shkelje e nenit 6 të Konventës, në aspektin e ushtrimit të funksionit nomofilatik të autoritetit më të lartë gjyqësor në një shtet, duhen marrë në konsideratë disa rrethana, konkretisht: *së pari*, nëse në jurisprudencën e gjykatave ekzistojnë qëndrime thelbësisht të ndryshme dhe të qëndrueshme mbi të njëjtën çështje juridike; *së dyti*, nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma ligjorë dhe proceduralë, që

synojnë në mënyrë efektive eliminimin e mungesës së koherencës në jurisprudencë; dhe *së treti,* nëse këta mekanizma janë zbatuar nga gjykata më e lartë dhe cili ka qenë efekti i tyre në praktikën gjyqësore. GJEDNJ-ja ka theksuar se juridiksioni gjyqësor suprem në çdo shtet duhet të tregojë vigjilencë në shquarjen dhe eliminimin e çdo mungese koherence në jurisprudencën e gjykatave (*shih çështjen "Mariyka Popova dhe Asen Popov kundër Bullgarisë", kërkesa nr. 11260/10, seksioni i 5 i GJEDNJ, vendim nr. 1104.2019, paragrafi 40).*

- Përcaktimi i rregullit njësues për praktikën gjyqësore

23. E drejta e pronës private, si një e drejtë themelore dhe një ndër shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës, gëzon mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta dhe ligji. Nenet 11, 41 dhe 42 të Kushtetutës garantojnë pronën private, kufizimin e saj vetëm për interes publik dhe të drejtën e subjekteve për një proces të rregullt ligjor, duke përfshirë të drejtën për të kundërshtuar gjyqësisht masën e shpërblimit në rast shpronësimi. Shpronësimi është i lejueshëm vetëm kur është i parashikuar me ligj, i domosdoshëm për interes publik, proporcional dhe i shoqëruar me shpërblim të drejtë, pa cenuar thelbin e së drejtës së pronës.

24. Prona, si e drejtë themelore, mbrohet gjithashtu nga instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së përcakton se askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik, në kushte të ligjshme dhe proporcionale. Këto parime kërkojnë që çdo kufizim të jetë i justifikuar, i parashikueshëm dhe i shoqëruar me garanci efektive gjyqësore.

25. Jurisprudenca e GJEDNJ-ja ka theksuar se mungesa e njoftimit efektiv në procedurat e shpronësimit vendos një barrë joproporcionale mbi pronarin, duke përbërë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 *(shih çështjen Morel kundër Turqisë, 14.06.2007).* Ky standard nënvizon se njoftimi i plotë dhe në kohë është element thelbësor i procesit të rregullt dhe garanci për ushtrimin efektiv të së drejtës së ankimit.

26. Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, konkretizon këto garanci, duke përcaktuar se akti shpronësues është vendimi i Këshillit të Ministrave, i cili i njoftohet drejtpërdrejt pronarëve të shpronësuar. Neni 24 i këtij ligji lidh afatin 30-ditor të ankimit gjyqësor me momentin e marrjes dijeni për vendimin, që nënkupton njoftimin e drejtpërdrejtë të subjektit të prekur.

27. Në vijim të këtyre garancive kushtetuese dhe ndërkombëtare, ligji nr. 8561/1999 ka përcaktuar një sërë mekanizmash proceduralë, që synojnë mbrojtjen efektive të pronarit gjatë procesit të shpronësimit. Këto përfshijnë njoftimin e drejtpërdrejtë e individual (neni 6), njoftimin për kërkesën për shpronësim (neni 14) dhe njoftimin për vendimin përfundimtar të shpronësimit (neni 24), të cilat kanë për qëllim sigurimin e transparencës dhe të mundësisë reale të pronarit për të ushtruar të drejtën e tij për ankim. Duke qenë se shpronësimi përbën kufizim të drejtpërdrejtë të pronës private, këta mekanizma synojnë të garantojnë një balancë ndërmjet interesit publik dhe mbrojtjes së subjektit të prekur, ndërkohë që legjislatori ka parashikuar mënyra të ndryshme njoftimi, të cilat kërkojnë interpretim të kujdesshëm për përcaktimin e afatit të ankimit.

28. Në këtë kontekst, saktësimi i kuptimit dhe funksionit të formave të njoftimit, si njoftimi i drejtpërdrejtë dhe njoftimi formal merr rëndësi të veçantë për të përcaktuar se nga cili moment fillon afati i padisë dhe nëse procedura e shpronësimit është kryer në përputhje me standardet ligjore dhe kushtetuese. Për këtë arsye, Kolegji vijon me analizimin e këtyre formave të njoftimit sipas KPA-ja dhe legjislacionit të posaçëm për shpronësimet.

A. Mbi kuptimin e termit "njoftim i drejtpërdrejtë" dhe "njoftim formal", sipas nenit 158 të Kodit të Procedurave Administrative.

29. Në vijim të analizës së rëndësisë së njoftimit në procesin e shpronësimit, është e nevojshme të shqyrtohet kuptimi që legjislatori i ka dhënë termit "njoftim i drejtpërdrejtë" në ligjin e posaçëm dhe marrëdhënien e tij me format e tjera të njoftimit të parashikuara në KPA. Neni 3 i ligjit nr. 8561/1999 përcakton se shpronësimi realizohet vetëm në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj, ndërsa neni 24/1, që rregullon posaçërisht të drejtën e ankimit për masën e shpërblimit, e lidh fillimin e afatit 30-ditor me momentin e marrjes dijeni për vendimin e shpronësimit, përmes njoftimit të drejtpërdrejtë të bërë nga organi kompetent. Kjo dispozitë përbën bazën e analizës së mëtejshme për dallimin ndërmjet njoftimit të drejtpërdrejtë dhe formave të tjera të njoftimit formal.

30. Në procedurën administrative të shpronësimit, njoftimi i drejtpërdrejtë individual i subjektit të shpronësuar nuk është i njëjtë me publikimin e kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare. Ky publikim ka qëllim të garantojë mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë që mund të preken nga shpronësimi *(neni 15, pika 1),* ndërsa njoftimi i drejtpërdrejtë synon të sigurojë dijeninë efektive të pronarit për aktin individual që e prek.

31. Ndryshimet e nenit 5 (Kuptimi i shpronësimit) pika 1 dhe 2, me ligjin nr. 11/2020, datë 12.02.2020, kanë theksuar rolin aktiv të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin (në vijim "ASHSH"). Pas pranimit të kërkesës për shpronësim, ASHSH lidh marrëveshje me subjektin përfitues dhe nis procedurat e njoftimit të drejtpërdrejtë për çdo pronar, bashkëpronar apo person të tretë, paralelisht me publikimin e kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare dhe faqen e saj elektronike. Mënyrat dhe përmbajtja e njoftimit përcaktohen me akt normativ të Këshillit të Ministrave.

32. Publikimi i kërkesës për shpronësim ka funksion plotësues, ai njofton publikun dhe personat e tretë, të cilët mund të paraqesin pretendimet e tyre brenda 15 ditëve nga përfundimi i afateve të publikimit. Këto pretendime shqyrtohen nga ASHSH-ja, e cila, nëse i gjen të mbështetura në ligj, i merr në konsideratë në procesin e shpronësimit.

33. Brenda 15 ditëve nga data e njoftimit sipas ligjit ose nga mbarimi i afatit të publikimit, pronarët, bashkëpronarët apo personat e tretë njoftojnë ASHSH-në mbi qëndrimin e tyre për kalimin vullnetar të pronësisë. Pas kësaj, ASHSH-ja, brenda 15 ditëve nga marrja e përgjigjeve dhe jo më herët se një muaj nga përfundimi i afatit të publikimit, kryen veprimet për kalimin e pronësisë kundrejt shpërblimit. Me përmbushjen e detyrimeve të ndërsjella, procedura e shpronësimit përfundon. Me pëlqimin e ASHSH, këto veprime mund të kryhen edhe pas afateve ligjore, për sa kohë Këshilli i Ministrave nuk ka marrë ende vendimin përfundimtar.

34. Në fazën përfundimtare, Këshilli i Ministrave, nëse propozimi rezulton i bazuar në ligj dhe në fakte, miraton vendimin për shpronësim, i cili hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Ky vendim njoftohet drejtpërdrejt nga ASHSH-ja subjekteve të shpronësuara dhe personave të tretë të kompensueshëm. Këto subjekte kanë të drejtë ta kundërshtojnë vetëm për masën e shpërblimit, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

35. Në këtë kuadër, për të kuptuar saktë përmbajtjen e *"njoftimit të drejtpërdrejtë"* si kriter ligjor për fillimin e afatit të ankimit, është e nevojshme të analizohet sistemi i formave të njoftimit të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Neni 148 parashikon: *"2. Një dokument i shkruar mund të njoftohet nëpërmjet dërgimit me postë, mjeteve elektronike, faks apo njoftimit formal, sipas parashikimeve të këtij Kodi.*" Ndërkohë që në nenin 158 të KPA-së parashikohen disa mënyra të njoftimit formal: *"Njoftimi formal bëhet nëpërmjet dorëzimit personalisht, njoftimit nëpërmjet të tretit apo postës, si dhe nëpërmjet publikimit elektronik, njoftimit publik apo botimit zyrtar, sipas parashikimeve të neneve 159 deri në 163 të këtij Kodi."*

36. Përderisa legjislatori e ka përfshirë njoftimin e drejtpërdrejtë brenda kategorisë së njoftimeve formale, shtrohet pyetja nëse të gjitha format e njoftimit formal, si *dorëzim personal, njoftim me postë apo të tretë, publikim elektronik, njoftim publik* ose *botim zyrtar,* mund të konsiderohen si njoftim i drejtpërdrejtë?

37. Ligji ka parashikuar disa mënyra të vlefshme për njoftimin, të cilat prodhojnë efekte juridike edhe kur nuk arrihet dorëzimi personal. Referuar nenit 159, pika 3 të KPA-së, të titulluar "Dorëzimi personalisht", "*1. Nëpunësi i organit publik i dorëzon personalisht shkresën marrësit në një nga vendet e njoftimit të parashikuara nga ky Kod."* Ndërkohë, pika 4, 5 parashikon rastet se edhe kur nuk gjendet personi në vendin e njoftimit, pra kur nuk i dorëzohet njoftimi personalisht, do të konsiderohet se është kryer njoftimi personal. Pra, kur marrësi nuk gjendet, nëpunësi bën shënimin përkatës në një procesverbal dhe kur është e mundur e vërteton situatën me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm, duke e konsideruar dorëzimin të kryer, pas 3 ditëve nga data e vendosjes së shënimit.

38. Të njëjtat rregullime bëhen edhe nga nenet 160–163 të KPA-së. Konkretisht, referuar nenit 160, të titulluar "Njoftimi nëpërmjet të tretit", kur nuk është i mundur njoftimi personalisht *(sipas nenit 159)* dhe marrësi nuk gjendet, nëpunësi i organit publik, pasi mban një procesverbal, bën dorëzimin nëpërmjet një të treti, që mund të jetë një person i familjes që ka mbushur moshën 16 vjeç, një fqinj

madhor, një punonjës apo portieri në vendin e njoftimit, një dëshmitari të pranishëm, ose me lënien në kutinë postare të vendbanimit, apo të vendqëndrimit të marrësit. Pikërisht, dorëzimi konsiderohet i kryer pas 3 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të shkresës nga personat e tretë ose nga data e lënies në kutinë postare. "*Njoftimi nëpërmjet publikimit elektronik*", sipas nenit 161, konsiderohet i kryer në një regjistër elektronik, "*në datën e përcaktuar për publikimin vetëm nëse dokumenti është publikuar faktikisht në atë datë*", ose nëpërmjet shkarkimit nga një server i caktuar, i mbyllur për publikun. Njoftimi publik sipas nenit 162 që bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet konsiderohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes. Ndërsa: "Botimi zyrtar, sipas nenit 163 të KPA-së bëhet nëpërmjet botimit në Fletoren Zyrtare ose në buletinet e njoftimeve zyrtare dhe konsiderohet i kryer brenda 10 ditëve nga data e botimit".

39. Nga analiza e mësipërme e dispozitave të KPA-së rezulton se legjislatori ka ndërtuar një regjim të plotë dhe të strukturuar të formave të njoftimit, të cilat, ndonëse të ndryshme në mënyrën e realizimit, synojnë të sigurojnë marrjen dijeni të subjektit të interesuar dhe prodhojnë efekte juridike të përcaktuara qartë. Në këtë kuptim, vlerësimi i natyrës dhe efektit juridik të secilës formë njoftimi bëhet vendimtar për përcaktimin e kuptimit të termit "njoftim i drejtpërdrejtë" në raport me fillimin e afatit të ankimit.

40. **Duke iu referuar çështjes së shtruar për njësim dhe me qëllim dhënien e përgjigjes, Kolegji konkludon se përderisa të gjitha format e njoftimit konsiderohen si të rregullta dhe ligjore, atëherë kryerja e njoftimit me secilën prej këtyre formave, do të konsiderohet si një njoftim i drejtpërdrejtë, që përmbush detyrimin ligjor për dijeninë e personit të interesuar. Pra, vetë ligji e ka pranuar se njoftimi drejtpërdrejt i personit të interesuar konsiderohet i kryer edhe me *njoftimin nëpërmjet të tretit apo postës, njoftimin nëpërmjet publikimit elektronik, njoftimin publik dhe me botimin zyrtar*, duke përmbushur të gjitha standardet që kërkon një proces i rregullt ligjor mbi mënyrën e njoftimit.**

41. **Pavarësisht se subjekti i shpronësuar është i përfshirë dhe në dijeni të plotë të të gjithë fazave paraprake të procedurës që ndiqet për shpronësimin *[si hyrja në negociata (neni 11/5/"d"); njoftimi i drejtpërdrejtë për kërkesën për shpronësim (neni 14); dijenia për publikimin e kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare (neni 15); shprehja e vullnetit për moskalimin vullnetar të pronësisë (neni 16)],* kjo nuk përjashton detyrimin ligjor të ASHSH-së për të njoftuar vendimin përfundimtar të Këshillit të Ministrave, në njërën nga format e parashikuara nga KPA-ja.**

B. Nga cili moment nis afati i parashkrimit të padisë në paditë me objekt kundërshtimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit, në rastet e shpronësimeve për interes publik?

42. Vendimi për shpronësimin është akt administrativ individual, për të cilin zbatohen rregullat e nenit 18 të LGJA-së: i. ***data e njoftimit*** të aktit administrativ; ii. ***data e botimit*** të aktit, kur ligji parashikon detyrimin për botim. Sipas nenit 24 të ligjit nr. 8561/1999, "Për shpronësimet...": *1. "Vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësimin u njoftohet nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin drejtpërdrejt pronarëve të shpronësuar".* Në këtë mënyrë përmbushet rregulli ligjor *(data e njoftimit)*, sipas nenit 18, shkronja "b" të LGJA-së për të përcaktuar nisjen e afatit 30-ditor të ngritjes së padisë. Referuar nenit 21, pika 5 të ligjit nr. 8561/1999, "Për shpronësimet...", si dhe nenit 29 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", vendimet e Këshillit të Ministrave me karakter individual: *"hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare".* Gjithashtu, në nenin 106 të KPA-së parashikohet: "*1. Botimi i akteve administrative në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm, kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji. 2. Mosbotimi i aktit në Fletoren Zyrtare, kur kjo kërkohet shprehimisht nga ligji, shkakton mos hyrjen në fuqi të aktit."*

43. Nga këto dispozita rezulton se ligji i posaçëm (ligji nr. 8561/1999) mund të nxisë dy lexime mbi momentin procedural të fillimit të afatit për padinë kundër vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin: sipas nenit 24, afati lidhet me njoftimin e drejtpërdrejtë, ndërsa sipas nenit 21, pika 5, në përputhje me nenin 29, pika 3 të ligjit nr. 9000/2003, vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet. Megjithatë, për shkak se ligji i posaçëm (ligji për shpronësimet) lidhet drejtpërdrejtë me njoftimin e individit të prekur (neni 24), parimi *lex specialis derogat legi generali* çon në përparësinë e njoftimit

individual ndaj botimit, si moment që përcakton nisjen e afatit të ankimit.

44. Ky interpretim, i cili nuk ka karakter thjesht teknik apo formal, lidhet drejtpërdrejt me garantimin e aksesit efektiv në drejtësi dhe me mbrojtjen reale të së drejtës së pronës, duke gjetur mbështetje në standardet kushtetuese dhe në jurisprudencën e konsoliduar gjyqësore, sipas të cilave njoftimi i akteve administrative me ndikim në të drejta themelore duhet të jetë real, efektiv dhe i personalizuar. Në procesin e shpronësimit, ASHSH-ja ka detyrimin të tregojë kujdes të shtuar për njoftimin e subjekteve, në përputhje me nenet 159–160 të KPA-së, duke garantuar të drejtën kushtetuese të pronës dhe të procesit të rregullt ligjor (nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës). Siç ka theksuar Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 29, datë 1.11.2022, organet publike duhet të sigurojnë njoftim efektiv e real të individit, në mënyrë që ky të ketë mundësi të mbrojë vlerën e pronës në të dyja fazat, atë administrative dhe atë gjyqësore.

45. Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese lidh fillimin e afateve të ankimit ndaj aktit individual që cenon të drejtat e personit me datën e marrjes dijeni nga personi për ekzistencën e aktit, pavarësisht formave të tjera të publikimit. Kjo datë, në çështjet e shpronësimit, është ajo e njoftimit të drejtpërdrejtë, dhe jo data e botimit të VKM-së në Fletoren Zyrtare[16].

46. Në zbatim të nenit 35 të LGJA-së, barra e provës për ligjshmërinë e procedurës së njoftimit i takon autoritetit publik. Ky i fundit duhet të dokumentojë përpjekjet e kryera për njoftim në adresat e njohura të subjekteve të shpronësuara dhe të demonstrojë se ka përdorur çdo mënyrë të përshtatshme të njoftimit të parashikuar nga ligji. Vetëm kur rezulton se njoftimi i drejtpërdrejtë është objektivisht i pamundur ose i papërshtatshëm, organi mund të kalojë në forma të tjera të njoftimit publik ose botimit zyrtar, në përputhje me nenet 160–163 të KPA-së.

47. Në vijim të rregullit mbi barrën e provës dhe mënyrat e njoftimit, Kolegji çmon të saktësojë natyrën juridike të "marrjes dijeni" në të drejtën administrative. Në këtë kuadër, në gjykimin administrativ nuk kërkohet dhe nuk mund të provohet dijenia faktike e subjektit për përmbajtjen e aktit administrative, ndërkohë që është autoriteti publik që ka barrën të provojë veprimet e kryera për njoftimin e drejtpërdrejtë, në përputhje me nenet 159–160 të KPA-së. Kur këto përpjekje rezultojnë objektivisht të pamundura, ligji parashikon një mekanizëm formal të marrjes dijeni, nëpërmjet të cilit njoftimi alternativ, përfshirë botimin në Fletoren Zyrtare, konsiderohet i kryer, pa u kërkuar provën e dijenisë reale të subjektit. Ky mekanizëm synon të shmangë bllokimin e procedurave administrative, por nuk zëvendëson detyrimin për njoftim të drejtpërdrejtë në çështjet që prekin të drejta themelore. Për rrjedhojë, botimi në Fletoren Zyrtare nuk përbën mënyrën e zakonshme të njoftimit në procedurat e shpronësimit, por ka karakter subsidiar dhe aktivizohet vetëm kur autoriteti përgjegjës provon se njoftimi individual ka dështuar për arsye objektive dhe se nuk ekziston asnjë mënyrë tjetër e përshtatshme për ta bërë atë efektiv, duke lejuar në këto kushte lidhjen e momentit të marrjes dijeni me botimin zyrtar, sipas nenit 163 të KPA-së.

48. Ky interpretim siguron mbrojtje më efektive të së drejtës së pronësisë gjatë procesit të shpronësimit. Siç vlerëson doktrina dhe praktika gjyqësore, kur subjekti preket drejtpërdrejt nga një akt administrativ, njoftimi duhet të realizohet në mënyrën më të sigurt dhe të personalizuar të mundshme. Botimi në Fletoren Zyrtare krijon vetëm një prezumim të përgjithshëm dijenie dhe, për shkak të natyrës individuale të VKM së shpronësimit dhe pasojave të saj të drejtpërdrejta për subjektet, nuk mund të zëvendësojë njoftimin individual. Nëse ligjvënësi do të kishte dashur që fillimi i afatit të ankimit të lidhej me botimin, nuk do të kishte parashikuar njëkohësisht detyrimin për njoftim të drejtpërdrejtë dhe të drejtën për ankimin gjyqësor në të njëjtën dispozitë (neni 24/1).

49. **Kolegji konkludon se, ndonëse ligji parashikon dy mënyra njoftimi, për përcaktimin e momentit të marrjes dijeni të VKM, nga i cili fillon llogaritja e afatit 30-ditor të paraqitjes së padisë për kundërshtimin e vlerës së shpronësimit, zbatohen dispozitat e ligjit të posaçëm *(lex specialis)* – njoftimi i**

[16] Gjykata Kushtetuese, vendimi nr. 30, datë 28.12 2006; nr. 22, datë 7.10.2008; nr. 15, datë 8.6.2009.

drejtpërdrejtë sipas nenit 24 të ligjit nr. 8561/1999. Prandaj, afati 30-ditor për kundërshtimin e vlerës së shpronësimit fillon nga data e njoftimit të drejtpërdrejtë të vendimit të Këshillit të Ministrave, i kryer nga ASHSH-ja. Vetëm nëse organi përgjegjës provon se kjo mënyrë njoftimi ka qenë objektivisht e pazbatueshme dhe se çdo formë tjetër njoftimi ka qenë e pamundur ose e papërshtatshme, momenti i marrjes dijeni konsiderohet data e botimit në Fletoren Zyrtare, në përputhje me nenin 163 të Kodit të Procedurave Administrative.

C. Mbi zgjatjen e afatit të paraqitjes së padisë

50. Rregullimi mbi afatet për paraqitjen e padisë administrative parashikohet shprehimisht në nenin 18 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar. Ky nen përcakton:

"1. Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afat fillon nga:

a) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ;

b) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë;

c) data e botimit të aktit administrativ, në rastet kur ligji parashikon detyrimin për botimin e aktit;

ç) data e marrjes së dijenisë për ndërhyrjen e paligjshme të organit publik mbi të drejtat dhe interesat ligjorë të subjektit, me çdo lloj veprimi që nuk plotëson kushtet dhe formën e aktit administrativ;

d) data e mbarimit të afatit ligjor për nxjerrjen e aktit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit administrativ, kur akti administrativ që është kërkuar të nxirret ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë;

dh) data e mbarimit të afatit ligjor për shqyrtimin e ankimit administrativ, në rastet e mosveprimit të organit më të lartë administrativ.

2. ***Afati i mësipërm është 1 vit, në rastet kur akti administrativ nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e padisë****. Në rastin e mosparaqitjes së padisë brenda 1 viti, për arsye se udhëzimet në aktin administrativ nuk japin informacion të saktë për të drejtën e padisë, padia paraqitet edhe pas 1 viti, por, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data kur paditësi ka marrë dijeni për ekzistencën e së drejtës së padisë dhe vetëm kur paditësi jep shpjegime të besueshme për këto rrethana në padinë e tij.*

[...]

7. Afatet e mësipërme janë të prera dhe shkelja e tyre shkakton humbjen e së drejtës së padisë. Këto afate shqyrtohen nga gjykata edhe kryesisht.[...]."

51. Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", ka përcaktuar disa rregulla të rëndësishme, por edhe specifike për momentin e marrjes së fuqisë juridike të vendimeve të Këshillit të Ministrave. Neni 29 i tij parashikon, se: "vendimet e Këshillit të Ministrave marrin fuqi juridike pas botimit në Fletoren Zyrtare"; ndërsa për vendimet me karakter individual përcakton, se: "hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare". Ky rregull shërben si garanci për transparencën e vendimmarrjes dhe për sigurimin e njohjes publike të akteve. Në të njëjtën linjë, nenet 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2012, "Për Qendrën e Botimeve Zyrtare", përcaktojnë se botimi në Fletoren Zyrtare përbën mënyrën zyrtare të bërjes publike të akteve ligjore dhe administrative, me qëllim njohjen e tyre dhe garantimin e së drejtës për informim.

52. Pra, botimi në Fletoren Zyrtare mbetet i detyrueshëm, si për hyrjen në fuqi të aktit, ashtu edhe për informimin publik, por nuk zëvendëson rregullin special për nisjen e afatit, përveç rasteve kur njoftimi i drejtpërdrejtë është i pamundur, ose i papërshtatshëm, dhe kjo provohet qartësisht nga autoriteti kompetent. Me botimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësim në Fletoren Zyrtare, akti bëhet i njohur botërisht. Sipas nenit 163/3 të KPA-së, njoftimi nëpërmjet botimit zyrtar konsiderohet i kryer brenda 10 ditëve nga data e botimit. Në rastet përjashtuese kur njoftimi i drejtpërdrejtë nuk ka qenë i mundur (nenet 159–160 të KPA-së) dhe kjo është provuar nga organi përgjegjës, momenti i marrjes dijeni për nisjen e afatit përcaktohet nga data e botimit (neni 63 i KPA-së, në lidhje me nenin 18/1, shkronja "c" të ligjit nr. 49/2012). Në të gjitha rastet e tjera, rregulli mbetet njoftimi i drejtpërdrejtë.

53. Në zbatim të nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, parashikohet se afati për paraqitjen e padisë është **një vit**, kur akti administrativ nuk përcakton qartë të drejtën dhe afatin e ankimit. Ky rregull zbatohet në të gjitha rastet e mungesës së udhëzimit të saktë mbi të drejtën për padi. Konkretisht, kur vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësim ose njoftimi përkatës nuk përmban sqarime të qarta mbi të drejtën dhe afatin e padisë,

subjekti përfiton afatin njëvjeçar për ushtrimin e saj. Në praktikë, kjo do të thotë se kur afati fillon nga **njoftimi i drejtpërdrejtë**, por njoftimi ose akti nuk përcakton qartë të drejtën dhe afatin e ankimit, zbatohet afati njëvjeçar; kur, për shkak të pamundësisë së provuar të njoftimit të drejtpërdrejtë, afati fillon nga **botimi zyrtar**, por as në këtë rast nuk jepen udhëzime të qarta, zbatohet po ashtu i njëjti afat njëvjeçar, në përputhje me pjesën e dytë të nenit 18, pika 2. Ky rregull për zgjatjen e afatit siguron proporcionalitet dhe efektivitet në ushtrimin e së drejtës për ankimin gjyqësor, duke mbrojtur palën nga pasojat e njoftimeve të mangëta ose të paqarta.

54. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në arsyetimin e mësipërm referuar pyetjes së shtruar për njësim vlerëson se, duhet të arrihet në përcaktimin e rregullit njësues:

- **E drejta për të paraqitur padi administrative për kundërshtimin e vlerës së pronës, objekt i shpronësimit për interes publik lind nga momenti i marrjes dijeni të vendimit të Këshillit të Ministrave, i cili duhet t'i jetë njoftuar në mënyrë të drejtpërdrejtë palës paditëse nga autoriteti përgjegjës (ASHSH), sipas neneve 159 e 160 të KPA-së dhe nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 8561/1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorin të përkohshëm të pasurisë pronë private për interesa publikë",* i ndryshuar**.

- **Në gjykimin administrativ autoriteti përgjegjës (ASHSH) ka barrën të provojë veprimet për njoftimin e drejtpërdrejtë të vendimit të Këshillit të Ministrave. Vetëm në rastin kur për arsye objektive, pronari nuk merr dijeni në adresën e njoftimit, pasi nuk gjendet, atëherë e drejta për të paraqitur padi lind nga momenti që prezumohet të ketë ardhur në dijeni nëpërmjet njoftimit ligjor më të përshtatshëm, që është botimi i vendimit të Këshillit të Ministrave në Fletoren Zyrtare, sipas nenit 163 të KPA-së.**

- **Në rastet e mësipërme dhe kur në përmbajtje të vendimit të Këshillit të Ministrave nuk parashikohet qartë e drejta dhe afati i ngritjes së padisë, atëherë afati për të ushtruar të drejtën e paraqitjes së padisë administrative për kundërshtimin e vlerës së pronës objekt i shpronësimit për interes publik do jetë një vit, sipas nenit 18, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar.**

- Zgjidhja e çështjes konkrete

55. Kolegji vlerëson se gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka trajtuar dhe vlerësuar afatin e paraqitjes së padisë në gjykatë. Kjo gjykatë ka rrëzuar padinë si të pathemeltë, duke e shqyrtuar mosmarrëveshjen në themel, pa analizuar kushtin formal të afatit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim vetëm pala paditëse, ndërsa pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit nuk kanë ushtruar kundërankim. Megjithëse çështja e afatit nuk është ngritur në shkaqet e ankimit, rezulton se Gjykata Administrative e Apelit e ka vlerësuar **kryesisht** këtë element formal të padisë administrative. Gjykata Administrative e Apelit arsyeton në lidhje me këtë kusht formal, se: "*VKM-ja nr. 795, datë 22.9.2015, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 170, datë 30.9.2015; padia është paraqitur me anë të shërbimit postar më datë 14.11.2015, pra duke nisur afati 30-ditor që nga data 1.10.2015, paditësi është dukshëm jashtë afatit të ngritjes së padisë. Paditësi ka pretenduar se është vënë në dijeni të VKM-së nr. 795, datë 22.9.2015, më datë 15.10.2015, por ky fakt sipas trajtimit që bën Gjykata e Lartë është irrelevant.*"

56. Kolegji rikonfirmon parimin e konsoliduar se vlerësimi i kushteve formale të padisë, përfshirë respektimin e afatit të paraqitjes së saj, është detyrë funksionale e gjykatave administrative, e cila ushtrohet edhe kryesisht, pavarësisht nëse palët e kanë ngritur si pretendim. Për të garantuar një vendimmarrje të drejtë dhe të ligjshme, gjykata duhet të realizojë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi këto çështje formale, duke respektuar ndarjen e barrës së provës ndërmjet palëve, në përputhje me nenin 35 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar.

57. Nga rrethanat procedurale të çështjes dhe arsyetimi i gjykatave të faktit, Kolegji arrin në përfundimin se zgjidhja e dhënë nuk është në përputhje me praktikën e njësuar të këtij vendimi. Në këto kushte, nuk janë plotësuar parakushtet ligjore për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes nga Kolegji, sipas nenit 63, pika 1, shkronja "dh", të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar. Përkundrazi, është e domosdoshme kryerja e një hetimi të plotë nga Gjykata Administrative e Apelit lidhur me respektimin e afatit të padisë dhe provat përkatëse të njoftimit të vendimit administrativ. Për këto arsye, Kolegji çmon se duhet të prishet vendimi

gjyqësor i dhënë në kundërshtim me ligjin dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, me trup gjykues tjetër. Në rishqyrtimin e çështjes, Gjykata Administrative e Apelit duhet: të hetojë dhe vlerësojë fillimisht kushtin formal të padisë, në përputhje me këtë vendim unifikues dhe me ligjin procedural në fuqi; nëse arrin në përfundimin se padia është paraqitur brenda afatit ligjor, të vijojë me shqyrtimin e shkaqeve të ankimit dhe t'u japë përgjigje të plotë, duke zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin dhe normat e tjera në fuqi (nenet 17, pika 2, 35 dhe 37 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 1, paragrafi 2, në lidhje me nenin 58, nenin 62/a, pika 2, dhe neni 63, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. 466, datë 10.11.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues.
2. Ky vendim njësues botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 14.5.2024.

Kryesues: Sokol Sadushi
Anëtarë: Arbena Ahmeti, Asim Vokshi, Gentian Medja, Enkelejda Metaliaj (Softa)

URDHËR
Nr. 332, datë 23.12.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE TË AUTORITETIT KONTRAKTOR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit/konkurrimit publik, për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë, znj. Llambriola Misto.
2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.
3. Kompetencat e deleguara në këtë urdhër mbarojnë me shfuqizimin e tij ose me pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, si dhe nëpunësit e aparatit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij urdhri.
5. Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri shfuqizohet çdo urdhër tjetër që bie në kundërshtim me të.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

KËRKESË
Nr. 1064/8, datë 24.12.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Tiranë–Elbasan' (shtesa)".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "ullishte" bazuar në VKM-në nr.

89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", dhe vlerësimi për kulturat bujqësore është kryer bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 5.10.2000, sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,961,032 (një milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tridhjetë e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA EMËRORE PARAPRAKE "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'TIRANË–ELBASAN' (SHTESA)"

Nr.	Pronari			Të dhëna hipotekore								Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Sipërfaqja e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (m²)	Drufrutor		
1	Zamir Rexhep Metani			2735	125/9	Ullishte	5000	1,739	399	693,861	1,267,171	1,961,032	Konfirmim nga ASHK-ja. Shpronësuar me VKM-në nr. 861, për 3261 m².
TOTALI												1,961,032	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 400 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/12/30 13:59:56 +02'00'
7feb3607b709478fa62ff7a824bcbcca20

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)